



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 7 MARS 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 7. MARTA 2019. GODINE**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë
2. Shqyrtimi i Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë

Dnevni red

1. Drugo razmatranje N/zakona br. 06/L-145 o zadacima, odgovornostima i nadležnostima Državne delegacije Republike Kosova u procesu dijaloga sa Republikom Srbijom,
2. Razmatranje Platforme za dijalog o konačnom, sveobuhvatnom i zakonski obavezujućeg sporazuma o normalizaciji odnosa između Republike Kosova i Republike Srbije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të kryeministrit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Aktualisht në sallë janë 83 deputetë.

Procedojmë me pikat e rendit të ditës

Zoti Hoti e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të qeverisë,

Ne e kemi kërkuar një seancë të jashtëzakonshme pardje dhe një tjetër dje, në asnjërën prej tyre deputetët e koalicionit qeverisës nuk kanë marrë pjesë me arsyetimin që janë tri ditë të Epopesë së UÇK-së.

Kemi kërkuar për çështje që janë fundamentale për funksionimin demokratik të shtetit të Kosovës, siç janë shpenzimet e Qeverisë nga buxheti i vendit, bllokimi i institucioneve të pavarura të KQZ-së. Sot është dita e tretë e Epopesë së UÇK-së, ku në fakt ka ndodhur masakra në Prekaz dhe sot Kuvendi mbledhet me kërkesë të kryeministrit për të shqyrtuar një çështje pa asnjë urgjencë që ka të bëjë me ngutjen sa më shpejt të zgjidhen problemet e brendshme për të hyrë në dialog me Serbinë.

Mendoj që kjo është fyerje për ato viktime dhe të mos jap kualifikimet pa vend këtu në Kuvend, po nuk ka asnjë kuptim që sot në ditën e tretë të Epopesë të UÇK-së Kuvendi të mbledhet për të shqyrtuar një çështje që, së paku jo në këtë ditë, nuk duhet të diskutohet në këtë ditë të rëndësishme për krejt ato viktime që ka ndodhur.

Prandaj, unë propozoj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së që kryeministri ta tërheqë kërkesën dhe ky debat të shtyhet për një ditë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Ky është një propozim, janë dy mundësi, një është mocioni procedural, dy është kryeministri.

Kryeministër, e dëshiron fjalën apo ta kesh parasyshtë është çështje juaj në interpretim, në qoftë se keni qëndrim të vazhdoni, do të thotë nuk ka nevojë fare, se unë propozimin mund ta shtroj vetëm si mocion procedural, si propozim të zotit Hotit, atëherë seanca e përcakton.

Ka një propozim të zotit Hoti, unë mund ta nxjerr mocion procedural, ka kërkuar që të shtyhet kjo seancë e jashtëzakonshme. Ju e dini si çdo herë Kuvendi e vendos, seanca vendos.

Unë mund ta vë në votim, deputetë kemi mjaftueshëm në sallë, ka të bëjë me mocion procedural, propozim i zotit Hoti.

85 deputetë janë në sallë. Ju e dini se çka thotë Rregullorja, e në cilin moment mund të shtyhet, do të thotë duhet 2/3 e deputetëve të cilët janë prezentë në sallë, që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

A jeni gati? Votojmë tash!

75 deputetë kanë votuar, 31 për mocionin procedural, 43 kundër dhe një abstenim. Kjo është gjendja.

Vazhdojmë me seancën e jashtëzakonshme.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë

Zoti Krasniqi, nuk të vërejta, a e dëshironi fjalën?

Duhet të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 57, paragrafi 9 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni FunkSIONAL raportues, pas e përfundon shqyrtimin Kuvendit i paraqet raport me rekomandime së paku 5 ditë pune para shqyrtimit të dytë në mbledhjen plenare.

Në raport përfshihet edhe mendimi i komisioneve të përhershme si dhe deklarimi për amendamentet e propozuara nga deputetët, nga komisioni, nga grupi parlamentar apo nga Qeveria.

Kërkohet deklarim me votim. Edhe një herë, të nderuar deputetë, kërkohet deklarim me votim për shmangie nga afati procedural të paraparë me Rregulloren e Kuvendit, për t'i shmangur Rregullores Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare.

Atëherë, shkojmë në votim. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

85 deputetë kanë votuar, 53 për, 31 kundër dhe një abstenim. Presim administratën të na japë sqarim.

Do të thotë 56 deputetë është dashur të jenë për, nuk kalon.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës të kësaj seance të jashtëzakonshme të thirrur nga kryeministri i Republikës së Kosovës.

2. Shqyrtimi i Platformës për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

Vetëm diçka, politikisht i kemi qëndrimet, Rregulloren e kemi, ju e dini që unë e zbatoj deri në fund, vetëm për të folur jo.

Jo, jo, tash jemi në pikën e dytë. Vendimi ishte juaji, është transparent, situata është shumë e qartë.

Arben, urdhëro fjalën!

ARBEN GASHI: Juridikisht platforma konsiderohet produkt i ligjit, i një ligji që nuk ekziston. Kemi problem procedural, problem logjik dhe problem juridik.

Problemi procedural është se Kuvendi vendosi të mos merret me këtë temë.

Problemi logjik është se platforma është produkt i ligjit.

Dhe, problemi juridik është se nuk ekziston ligji për këtë platformë. Pra, për të hyrë ligji në fuqi, pa u aprovuar ligji dhe të hyjë në fuqi, nuk mund të diskutohet platforma, sepse ligji thotë duhet të nxirret një platformë dhe ai ligj nuk ekziston, nuk ekziston ligji, qysh mund të ekzistojë platforma.

Pra, Kuvendi nuk mund të aprovojë diçka, i cili bazohet në një ligj, i cili nuk ekziston, nuk ka ligj për platformën, sepse neni specifik i ligjit thotë: “Duhet të miratohet një platformë”.

Prandaj, mendoj se nuk kemi objekt pune dhe nuk mund të vazhdohet kjo seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Është qartësim procedural. Deputetët kur donë, e dinë këtë çështje, po për opinionin publik.

Ajo të cilën e shtroi Arbeni e ka interpretimin logjik edhe real përfundim të pikës së dytë, është reale ajo. Po proceduralisht e kemi të njëjtën situatë sikurse dje, kur kryeministri e ka kërkuar seancën e jashtëzakonshme.

Kryeministri ka të drejtë ta kërkojë seancën e jashtëzakonshme, ne futemi e kjo është vendimmarrja të cilën e kemi në seancë.

Po ashtu, edhe të cilën e ngriti deputeti Arben Gashi, është e qëndrueshme në aspektin logjik, edhe veprimin të fundit, për arsye se ne nuk mund të procedojmë në votim, po të hyjmë në pikë të rendit të ditës, mundemi.

Unë këtu jam vetëm gardian i Rregullores, tash shkojmë, mund të bisedojmë, ne mund ta diskutojmë, po vendimmarrje në fund nuk mund të marrim, se është ajo të cilën e thatë ju.

Kryeministri e ka bërë kërkesën, këto situata i kemi ditur edhe dje dhe kryeministri e vendos në goftë se vazhdojmë, ne e vazhdojmë proceduralisht, Kuvendi vendos veç në fund me votim.

(Ndërhyrje)

Ju shikoni, keni juristë të tjerë, po unë po ju them se kështu është dhe kështu do të jetë deri në fund, për faktin se kjo është Rregullorja. I ka këto mangësi, të cilat i tha Arbeni, logjikisht nuk e ka kuptimin të shkojë, proceduralisht me këtë çka e ka aprovuar ky Kuvend ne duhet të procedojmë.

Ne do të futemi në pikën e dytë të rendit të ditës, por në fund votim nuk ka, kurrfarë koncepti s' mund të votojmë për këtë çështje, po diskutimin mund ta kryejmë.

Avdullah Hoti, edhe Albulena Haxhiu e kanë kërkuar fjalën. Fjala do t'u jepet të gjithëve. Urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë po kuptoj që ju e keni respektuar dje kërkesën e kryeministrit veç të mblidhet Kuvendi, sepse kryeministri mund të kërkojë që Kuvendi të mblidhet kurdo për të shqyrtuar një çështje dhe i takon Kuvendit të vendosë si të procedojë tutje.

Në pikën e parë nuk kishte vota të mjaftueshme për t'u shmangur nga procedura sipas Rregullores së Kuvendit, që i bie sot Kuvendi nuk mund të shqyrtojë ligjin për dialog.

Si rezultat nuk ka asnjë logjikë që të diskutohet një platformë, e cila derivon nga ky ligj. Së pari duhet të kryhet ligji, i cili edhe ashtu është antikushtetues, e tek mandej të lëvizim në këtë pikë.

Ju edhe vetë po e konstatoni që nuk ka logjikë që Kuvendi të vazhdojë kështu punimet.

KRYETARI: Zonja Haxhiu, pastaj edhe zëvendëskryeministri Limaj ka kërkuar fjalën. Debat jemi duke bërë, të lutem.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, këtë çështje që po diskutohet këtu ne e kemi ngritur edhe në Komisionin për Punë të Jashtme, kur Komisioni për Punë të Jashtme i kishte dy pika në rendin e ditës, Projektligjin për dialogun dhe platformën, sikurse është edhe sot.

Dhe qëndrimi opozitar ka qenë, madje që është i bazuar në vetë dokumentet që ju i keni sjellë në këtë Kuvend, që ne nuk mund të vazhdojmë me votim të platformës, madje as shqyrtim të saj përderisa Projektligji për dialogun nuk ka hyrë në fuqi.

Edhe duke marrë parasysh faktin paralajmërimet e opozitës që duke pasur parasysh që Projektligji për dialogun bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ne do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, në qoftë se kryeministri Haradinaj nuk tërhiqet nga ai projektligj skandaloz dhe jokushtetues.

Prandaj, duke e ndjekur këtë logjikë, ju duhet të prisni derisa ky ligj të shpallet në Gazetën Zyrtare. Pra, derisa Gjykata Kushtetuese ta marrë vendimin ose aktgjykimin për këtë projektligj, sepse Gjykata Kushtetuese mund të kërkojë masë të përkohshme që ky ligj të mos hyjë në fuqi derisa ta kemi një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.

Dhe, çështja tjetër, ne votuam për shmangie, votuam për shmangie për të dyja çështjet, sot nuk i kemi dy kërkesa për seanca të jashtëzakonshme, e kemi vetëm një.

Prandaj, ne i refuzuam me anë të votës tonë, pra nuk pranuan që këto të futen sot në diskutim.

Prandaj, nuk ka kuptim që të vazhdohet me pikën e dytë për sa kohë Kuvendi e ka dhënë fjalën.

Pra, kjo seancë duhet të përmbyllet dhe të vazhdojmë me seancën tjetër të rregullt. Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri, zoti Limaj e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: Natyrisht, për pa u futur në procedura të asaj se si punon Kuvendi i Kosovës, e kjo ju takon juve, kryetar i Kuvendit, dhe deputetëve.

Ajo që unë desha të them janë dy fjalë, një çështje krejt tjetër.

Së pari, duhet të dallohet ligji me platformën, janë dy sende krejt të ndryshme. Nuk lidhet projektligji me platformën.

Platforma është një dokument politik i propozuar nga Delegacioni Shtetëror, Qeveria dhe Qeveria e ka propozuar këtu.

Është një Delegacion Shtetëror që është i votuar në Parlamentin e Kosovës.

Ligji rregullon kompetencat ose funksionimin e Delegacionit Shtetëror, nuk ka lidhje me një dokument politik.

Dhe, natyrisht, nëse këtu ka vullnet, mund të shkohet edhe të diskutohet platforma, edhe të votohet platforma pa pasur kurrfarë lidhje me Projektligjin për dialogun.

Tash mbetet në vullnetin e deputetëve a duan ta votojnë shmangien nga rendi i ditës për t'u futur kjo çështje në rend dite apo jo.

Mirëpo, janë dy sende të ndryshme Projektligji me platformë është dokument politik, përveç se ai, për t'u thirrur në dokumentet e Parlamentit, platforma vjen si rezultat i obligimit që ka dhënë Parlamenti i Kosovës përmes rezolutës kur e ka miratuar Delegacionin Shtetëror të Kosovës dhe nga ajo rezolutë ka rrjedhur përgatitja e platformës dhe ajo platformë ka dalë në Parlamentin e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Është i mirë ky diskutim për hir të opinionit publik. Të gjitha çka po bisedohen në këtë rast kanë të bëjnë me rregullat që i kemi ne.

Ne edhe dje e kemi biseduar, Kryesia edhe kolegët që kanë qenë përfaqësues të grupeve parlamentare e dinë këtë. Ne edhe dje e kemi ditur ballafaqimin me këtë situatë, a është kështu ju që keni qenë të pranishëm?

Tash jemi në një situatë ku vendimmarrje nuk mund të marrim, vendimmarrje e cila vjen ndesh, që tha zonja Haxhiu, nuk vjen në pyetje për faktin se unë nuk do të lejoj që të kemi një vendimmarrje, e cila që nga faza fillestare e krijon predispozitën të shkojë në Gjykatë Kushtetuese.

Për hir të opinionit publik Rregullorja do të zbatohet deri në fund, vendimmarrja do të jetë e seancës, por këto procedime janë krejt normale, është çështje e interpretimit, po janë normale.

Atëherë, Dardan Molliqaj, Armend Zemaj, Arben Gashi, Elmi Reçica, Milaim Zeka.

Replikë, a të përmendi? Kë e ka përmendur, atëherë kërkoj falje, Dardan.

Armend, ta jap fjalën si deputet. Dardan Molliqaj, fjala për ju. Pastaj Armend Zemaj, si deputet, Elmi Reçica.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit!

Vetëm për çështje procedurale, se po më duket që ka një keqkuptim.

Seanca e jashtëzakonshme thirret ose me 40 nënshkrime ose prej kryeministrit qysh është e rregulluar.

Ligji për dialogun i rregullon detyrat, përgjegjësi dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror. Ai nuk mund të ndërhyjë se çfarë aktesh nxjerr Kuvendi i Kosovës, s'ka rëndësi. Aktet e Kuvendit janë të rregulluara me Kushtetutë dhe me Rregullore, e aktet e Kuvendit janë të parapara ligjet, rezolutat dhe akte të tjera.

Pra, ne nuk do të mundemi edhe po të miratohej ligji formalisht ta quajmë platformë këtë vendim të Kuvendit. Kjo do të quhet ose rezolutë ose akt tjetër, kështu që nuk ka asnjë arsye, as procedurale e as ligjore për t'u shtyrë debati, përveç nëse ka arsye politike, qoftë për kërkesën që ju keni, qoftë për mungesë të numrave për t'u votuar ajo. Po nuk ka shkelje dhe jeni duke e përzier kot këtë farë çështje.

Kështu që asnjë ligj, jo ky po, edhe cilindo ligj që ju e bëni nuk mund t'i shtoni ose t'i mungojnë aktet ligjore të cilat i nxjerr Kuvendi i Kosovës, ato janë të parapara me Kushtetutë dhe Rregullore, ne e quajmë platformë, po ajo do të marrë formën ose të rezolutës ose akte të tjera të Kuvendit.

Ky është interpretimi i saktë dhe po më vjen keq që po doni çdo gjë ta shfrytëzoni për ta bllokuar, është pozicion juaj politik, po nuk keni të drejtë proceduralisht, keni të drejtë politikisht.

Kështu që, në rregull është ajo punë. Unë besoj që nëse e kemi shumicën në Kuvend për të vazhduar, besoj që duhet të vazhdojmë dhe të ecet tutje të debatojmë platformën.

Ndërsa sa i përket ligjit, është e drejtë që s'kemi sot mundësi ta vazhdojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall, në emër të grupit parlamentar, të gjithë do ta kenë fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Mendoj që këto dy gjëra, platformën dhe ligjin, duhet t'i trajtojmë edhe sot, veç e veç, për një arsye edhe procedurale.

Do të përqipem të shpjegoj këndvështrimin tim sa i përket procedurës.

Nëse Ligji për dialogun ka qenë në procedurë të Kuvendit dhe për arsye se ka qenë në procedurë, është kërkuar që të ketë shmangie nga Rregullorja.

Seancës së jashtëzakonshme që e thërrasin qofshin 40 deputetë apo kryeministri apo presidenti nuk i nënshtrohet tema të cilin e trajton, nuk i nënshtrohet shmangies, sepse vendimin për të debatuar për një çështje e marrin deputetët apo autoriteti që e ka thirrur dhe deputetët nuk mund të përjashtojnë temën.

Ndërsa sa i përket ligjit, meqë ka qenë në procedurë dhe është shqyrtuar në lexim të parë dhe në lexim të dytë ka pasur të vijë pas dy javësh, me kërkesë të kryeministrit është thirrur që ajo të mbahet sot, prandaj ka pasur nevojë për shmangie.

Përndryshe, po të ishte, ta zëmë, në lexim të parë, nuk do të kishte nevojë për shmangie dhe Rregullorja, meqë nuk është lexim i dytë, po thjesht po sillet në Kuvend për të debatuar, nuk i nënshtrohet rregullit të shmangies.

Prandaj, Kuvendi është i lirë të vazhdojë të debatojë për platformën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nënkryetari e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë për kërkesën e kryeministrit kam pasur dilema edhe dje dhe i kam shprehur në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, sa i takon bazës kushtetuese të saj, por ajo është çështje tjetër dhe ne jemi këtu.

Tani, kryeministri ka kërkuar një seancë të jashtëzakonshme lidhur me një çështje, a pjesëtohet ajo në disa pika të rendit të ditës apo mbetet si një, nuk ka rëndësi, sepse është një çështje dhe për çështjen, të cilën e ka kërkuar kryeministri që ne të debatojmë dhe të vendosim ose jo, Kuvendi u shpreh me votë. Domethënë, ne s'kemi më objekt pune. Kërkesa e kryeministrit nga seanca nuk është cilësuar si urgjente, s'është pranuar, domethënë është rrëzuar dhe s'mund të ecim më tutje.

KRYETARI: Faleminderit! Elmi Reçica e ka fjalën!

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Të njëjtën situatë ne e kemi pasur edhe në Komision Parlamentar për Punë të Jashtme, realisht ne kemi votuar që të debatohet dhe kemi pasur një renditje që së pari duhet të votohet projektligji dhe të shndërrohet në ligj, pastaj platforma.

Mendoj që duhet të vlejë e njëjta çështje, realisht të zbatohet i njëjti parim edhe këtu. Ne mund ta debatojmë këtë çështjen e platformës, pastaj normalisht brenda ditës dhe brenda javës, ose kur të krijohen kushtet, ne do ta votonim projektligjin dhe pastaj pas projektligjit do ta votonim platformën. E drejta e një pjese të opozitës është e padiskutueshme, ata edhe ashtu e kanë të qartë qëndrimin e tyre, janë kundër njëres dhe kundër tjetres. Për mua si deputet, dhe për grupin tonë parlamentar është e çuditshme që nuk po jepet mundësia që Parlamenti të jetë i kyçur në bisedime ose finalizimin e bisedimeve me Serbinë dhe kjo është e çuditshme. Gjersa këtu ka gjithmonë kundërshtime, gjithmonë ka anime, ka protesta që Kuvendi është lënë jashtë krejt këtij procesi dhe krejt këtyre procedurave, tash është mundësia që Kuvendi vërtet të jetë i përfaqësuar dhe çdo dialogim, bisedim, edhe finalizimi i këtij dialogu të kthehet dhe të deklarohet Kuvendi.

Kjo mendoj që nuk do të duhej të na pengojë, siç thuhet “Lisi për të parë pyllin”, nuk do të duhej çështjet që janë të vogla për t’ia rikthyer Parlamentit, realisht atë çfarë i takon, të marrë vendimin e duhur rreth kësaj çështjeje shumë të rëndësishme për vendin tonë.

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi e ka fjalën!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket procedurës është e sqaruar shumë mirë në nenin 69, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kush e thërret seancën e jashtëzakonshme, e thërrasin 40 deputetë të nënshkruar, Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, pa i përcaktuar temat, të cilat mund të jenë të diskutueshme në seancë të jashtëzakonshme.

Kryeministri ka bërë kërkesë me dy pika, të cilat janë të cekura në rendin e ditës, prandaj duhet dy pikat të jenë të diskutuara në këtë seancë. E para, u pa, domethënë nuk kaloi, e dyta duhet të hyjë në seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Po më duket pak është e padrejtë interpretim selektiv të Rregullores së Punës së Kuvendit, duke marrë parasysht që edhe vetë miratimi i saj e ka shumicën e kualifikuar, që do të thotë me 2/3 në

raport të barabartë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Edhe mua më vjen keq për deputetët e vjetër, edhe ata që janë pjesëmarrës edhe të hartimit të Rregullores së Punës së Kuvendit, për të rinjtë kam mirëkuptim kur interpretojnë normat ashtu siç e shohin situatën edhe kanë dëshirë dhe kjo është normale.

Unë mendoj dhe ju duhet ta dini, dhe ju e saktësuat në fillim për shmangie të Rregullores nga rendi i ditës që nënkupton të dy pikat. Çdo dokument që votohet, qoftë dokument politik apo platformë, sido që ta quani, shndërrohet në dokument juridik kur votohet dhe është obligues për ekzekutivin dhe për të gjithë ata që e zbatojnë ligjin në Republikën e Kosovës.

Për këtë arsye ne votuam për shmangie të Rregullores, ashtu siç e parasheh procedura kuvendore edhe Rregullorja e Punës sipas nenit 58, pika 9 dhe ajo nuk e përmbushi kërkesën legjitime të kryeministrit për seancë të jashtëzakonshme, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme. Andaj, ju kisha lutur që ta ndërprisni këtë seancë, nuk është e drejtë të vazhdohet pa vullnetin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Çdo interpretim tjetër është i pasaktë, i padrejtë dhe tendencioz, ju e dini, edhe e dinë shumica e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, këtë po e bëjmë më shumë për hir të qytetarëve ta kuptojnë tendencën, pse ju dëshironi të vazhdoni. Më mirë është të tregoni atë çka e keni në brendi dhe cili është interesi që ju të vazhdoni me platformën, se sa të mundoheni të tregoni apo të interpretoni Rregulloren e Punës në kundërshtim të plotë me atë çka është e shkruar e bardha në të zezë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ke zgjuar reaksion të një kolegu deputet, po pasi s'ia ke përmendur emrin, s'mund ta jap fjalën, Bilall, e di që të ka lënduar në interpretim, por jo, s'mundem. Po, tash jo, s'ia ka përmendur emrin.

Po, zëvendëskryeministër, a e dëshiron tash fjalën?

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: Shikoni, unë po besoj që ne po i dimë procedurat, po jemi duke bërë lojë fjalësh. Janë dy gjëra krejt të ndryshme, e para Kryeministri i Kosovës, siç e lexoi shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës kompetencat në Rregullore me nene, dhe ju tha e pranon nenin 58, por jemi duke folur për dy tema të ndryshme.

E vërtetë është që sikur që u kërkua nga kryetari i Kuvendit shmangie nga Rregullorja për rend dite në pikën e parë, për faktin se Projektligji për dialogun ka qenë në fazën e leximit të dytë. Kryeministri i Republikës së Kosovës, sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, ka të drejtë gjithmonë, sikur çdoherë që ka ndodhur këtu kurdo për një pikë të rendit të ditës që s'ka hyrë në procedurë të thërrasë pa pasur nevojë të kërkojë shmangie nga Rregullorja për rend dite, vetvetiu në rend dite. Prandaj, platforma, diskutimi për platformën është një çështje krejt ndryshe nga projektligji dhe ajo nuk ka nevojë të kërkohet shmangie nga Rregullorja, por drejtpërdrejt është

pikë e rendit të ditës dhe duhet të hapet diskutimi rreth platformës. Ajo pjesë për projektligjin, ke të drejtë, u mbyll, nuk kaloi, mirëpo për platformën as nuk duhet të kërkohet shmangie nga Rregullorja, sepse është një temë krejt tjetër.

Shikoni, ju e dini, Armend, për çka po flas, po flasim për një rezolutë politike, rezolutë politike, kryeministri në çdo kohë mund ta kërkojë në rend dite pa pasur nevojë votën për shmangie. Ia garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Rregullorja, kështu që, i nderuar kryetar, duke respektuar procedurat, siç u përmendën këtu nga kolegët, për atë edhe që u respektua rreth projektligjit nga shmangia e Rregullores, shpresoj që në një moment tjetër do të jenë votat e mjaftueshme për të shkuar dhe për të shmangur. Ju ftoj që të futemi në pikën e dytë që ka kërkuar Kryeministri i Republikës për platformën, të cilën nuk ka nevojë dhe nuk kërkohet vota për shmangie.

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm pak, për arsye se çështja ka të bëjë më tepër me qytetarët se sa me seancën. Ne edhe dje e kemi pasur të njëjtën situatë, të nderuar kolegë deputetë, nga opozita. Pretendimet nuk janë të qëndrueshme, unë vetëm po e sjell qëndrimin e djeshëm. Qëndrimi i djeshëm, aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të datës...

(Ndërhyrje)

Jo, jo vetëm te thirrja e seancës, e njëjta situatë, Armend, ka qenë, edhe dje ka qenë, keni aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese në kërkesën e Glauk Konjufcës, 22 shkurt 2018. Ju, zoti Konjufca, kur e keni bërë se ka të drejtë, është aktvendim i Gjykatës Kushtetuese kryeministri të thërrasë seancë të jashtëzakonshme, edhe për çështje, të cilat ai i kategorizon që janë urgjente.

Kjo është, shkojmë, unë debatin nuk po e ndal, Bilall, të lutem, mos fol në telefon, urdhëro, fol në seancë. Fol, se po e shoh po insiston, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Kryetar, nëse ju 3-4 herë mund të merrni fjalën, mundem edhe unë 2 herë.

Kolegë të nderuar deputetë, ajo që desha të them është kjo, për të qenë koherent, meqë po flasim për korrektësi dhe koherencë, nëse ju konsideroni që kjo seancë është ftuar jashtë Rregullores, siç e keni thënë edhe dje në Kryesi, nëse keni ardhur në përfundim se kryeministri nuk paska të drejtë të ndërhyjë në proces të një ligji kur është në lexim të dytë, pse morët pjesë në votim për shmangie? Pse nuk qëndruat koherentë dhe të mos merrni fare pjesë në votim në një seancë, e cila qenka ftuar jashtë Rregullores dhe Kushtetutës dhe të shfrytëzoni instrumentet që ua jap Kushtetuta, të shkoni në Gjykatë Kushtetuese për shkelje të Rregullores nga ana e 50, 60, 70 deputetë sa janë që kanë mbetur këtu.

Ajo që dua të them është, sikur seancat që ftohen të jashtëzakonshme të kërkojnë shmangie, asnjëherë nuk mbahen seancat e jashtëzakonshme nëse do të kërkohej shmangie për çdo çështje. Shmangia nënkupton vetëm për çështjet për të cilat Kuvendi është në pronësi, siç u tha, ligji ka qenë në pronësi të Kuvendit në lexim të dytë dhe sidomos për seancat e rregullta, kur një grup deputetësh apo një grup parlamentar kërkon të fusë në rend dite në një seancë, e cila është duke u zhvilluar, të futë një pikë të rendit të ditës në seancë, atëherë kërkohet shmangia. Por, për seanca të jashtëzakonshme, për çka do që kryeministri, presidenti dhe 40 deputetë dëshirojnë të fillojnë seancën, ajo fillon pa asnjë fjalë, ju i bëtë disa, faleminderit, por megjithatë jeni korrektë, ose mos merrni fare pjesë në seancë as në votim, ose lëreni, e fituat betejën e parë, lëreni këtë të dytën le të zhvillohet beteja për ide rreth platformës. Faleminderit!

KRYETARI: Po e shoh Avdullahun, por pastaj kryeministri ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Thashë, ne jemi duke folur për procedurë, të mos hyjmë te përmbajtja, sa i përket përmbajtjes ne e kemi të qartë dhe besoj të gjithë pajtohemi, janë dy dokumente shumë absurde që sot Kuvendi i debaton, por ta lëmë atë anash. Të flasim veç për procedura, zëvendëskryeministër, a më lejon?

Për procedura, më 6.3.2014, Komisioni Funkcional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike e ka shqyrtuar draft platformën për dialog, e tjera, e tjera. E cila tash, nëse doni të diskutoni, prapë i kërkon 2/3 për t'u shmangur, sepse duhen së paku 5 ditë për të ardhur në seancë, janë rregulla të shkruara në Rregulloren e Punës së Kuvendit, nuk është diskrecion as i Bilallit, as i kurrkujt që t'i tejkalojë këto rregulla. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën! Pastaj, Arbeni është në radhë dhe vazhdojmë tutje.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

Nënkryetarë,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Media të respektuara, kor diplomatik, qytetarë.

Pra, është kërkuar një seancë e jashtëzakonshme për temën mjaft aktuale, pra për tema vërtet që janë preokupim i të gjithëve, besoj. Nuk e di cili subjekt politik, cili protagonist i jetës politike nuk i ka interes këto tema, janë të interesit të parë për Kosovën. Nëse ka vërejtje për aspektin kohor, se a është sot dita t'i diskutojmë këto apo jo, nuk ka dilemë që mund t'i diskutojmë këto, mirëpo nuk besoj që dikush mund të mohojë rëndësinë e temave, mendoj që edhe Ligji për Delegacionin Shtetëror, por edhe platforma janë tema që e kanë vendin në këtë Kuvend dhe unë i kisha ftuar deputetët sot ta shfrytëzojnë mundësinë, pra t'i thonë pikëpamjet e veta, mendimet e veta, subjektet politike t'i thonë qëndrimet e veta dhe, në fund, mundësisht të arrijmë te një

konsensus, se i është dhënë mundësia Parlamentit jo vetëm ta ruajë pronësinë mbi procesin e dialogut, por edhe ta ruajë Kosovën e 17 Shkurtit.

Kështu që, të gjithë besoj e keni sot mundësinë për të dhënë pjesën tuaj të kontributit për një proces që është aktual, që është i rëndësishëm, që na preokupon të gjithë neve. Unë nuk dua sot të elaboroj rëndësinë e Ligjit për dialogun, sepse kolegët e mi, zëvendëskryeministra që janë edhe anëtarë të Delegacionit Shtetëror edhe do ta bëjnë, ose të platformës, por ju e dini është një debat i gjallë në Kosovë, është në arenën ndërkombëtare, vazhdon një diskutim i pandalshëm për proceset që na preokupojnë ne, mendoj që edhe diskutimet tuaja do të ishin ndihmesë, pra kontributet tuaja sot për këto tema, jeni deputetë të lirë të popullit, ju lutem, shfrytëzoheni mundësinë, jepeni kontributin tuaj për këto dy tema me rëndësi për Kosovën në këtë etapë kohore që jemi.

Pra, kisha kërkuar prej deputetëve, prej Parlamentit që të fillojnë diskutimet për platformën. Çështja e votimit është çështje e numrit të deputetëve prezentë, pushteti e mban përgjegjësinë dhe ata i sigurojnë kur i kanë votat, po çështja e diskutimeve, pozicioneve politike për temë besoj që është e të gjithëve dhe ju lus që ta shfrytëzoni këtë mundësi. Ne gjatë ditës e kemi të paraparë edhe kuorumin për votë do ta arrijmë aty, po çka është më me rëndësi është që derisa votohet ose nuk votohet, të paktën të jepni pikëpamjet tuaja që na takojnë të gjithëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Arben Gashi e ka fjalën, megjithëse më mirë do të ishte të hyjmë në debat.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Tash që t'i sqarojmë pak gjërat, ne në tavolinë kemi një raport me rekomandime nga Komisioni Funkcional. Ky raport nuk i plotëson kushtet formale juridike për t'u trajtuar, sepse nuk kanë kaluar 5 ditë pune. Për t'u bërë kjo punë, që të hyjë në rend dite, duhet me 2/3 të vendosë Kuvendi, me 2/3 e pranishmëve, kjo është çështja procedurale.

Te çështja përmbajtjesore që e kam me zotin Limaj, unë e kam Projektligjin që e keni propozuar, kreu 3: "Funksionet, kompetencat, vendimmarrja", neni 9 "Funksionimi i Delegacionit Shtetëror". "Delegacioni Shtetëror, i mandatar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, funksionon sipas dokumenteve themelore si vijojnë: pika 1.1. platforma shtetërore dhe strategjia negociuese e Delegacionit Shtetëror". Pra, platforma duhet të derivojë prej ligjit, i cili nuk ekziston, a i keni shkëputur këto dyja, duhet propozuar diçka tjetër Kuvendit. Pra, a është duke iu propozuar Kuvendit një dokument që rrjedh prej këtij ligji që nuk ekziston, apo është diçka tjetër, sepse e keni nxjerrë çdo gjë në lajthitje, proceduralisht, formalisht, përmbajtjesisht, ligjërish është një tollovi e jashtëzakonshme, siç është vetë tollovi edhe ky koalicion, po më duket. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, zëvendëskryeministri Limaj e ka fjalën, bëhet gati Glauk Konjufca.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: Shumë seriozisht, me procedura të merremi, Kujtim. Në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, më 15 dhjetor 2018, kur është miratuar Rezoluta për dialogun dhe për delegacionin, njëra nga pikat në këtë rezolutë, “Delegacioni Shtetëror i Kosovës obligohet që brenda afatit 30 ditor nga themelimi dhe funksionalizimi i tij t’i paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës projekt-dokumentet në vijim”.

(Ndërhyrje)

Ajo që po bëj, po e lexoj një dokument të quajtur Rezolutë që ka miratuar Parlamenti i Kosovës, mbi bazën e së cilës është krijuar Delegacioni Shtetëror i Kosovës me votat e deputetëve të Parlamentit të Kosovës.

Në atë rezolutë, në një nga pikat thotë: “Delegacioni Shtetëror i Kosovës do të obligohet që brenda afatit 30 ditor nga themelimi, funksionalizimi i tij t’ia paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës projekt-dokumentin si në vijim: projekt-platformën e dialogut, ku do të saktësohet të gjitha parimet udhëheqëse, mbi të cilat Delegacioni Shtetëror do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në procesin e dialogut”, një, dhe e dyta, Projektligjin për dialogun dhe projektligji është një procedurë krejt tjetër me projekt-dokumentin për platformën. Edhe një herë, zoti kryetar, kërkoj nga ju që të fillojmë debatin për të paraqitur platformën para deputetëve të Parlamentit të Kosovës, sepse është një debat, kjo rreth procedurës është një debat i shterur dhe i pambështetur në asnjë procedurë. Edhe një herë, të nderuar kolegë deputetë, unë besoj që jemi të interesuar, besoj që kjo temë është shumë e rëndësishme për të gjithë neve dhe duhet t’i japim mundësi Parlamentit të Kosovës, duhet t’u japim mundësi njerëzve, të gjithë juve që të diskutojmë mbi bazën e tij, përmbajtjes së platformës që besoj është me interes për vendin. Procedurat janë të respektuara, çdo gjë, vonesë e zvarritje pastaj ka implikime të tjera që nuk janë në interes të vendit.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca, të lutem! A ta ka përmendur emrin? Atëherë, në qoftë se ta ka përmendur emrin, Glauk, të lutem, regjia për replikë Armend. Fatmiri po thotë s’e ka përmendur. Pastaj, ti del keq, për mua merre fjalën, po ti del keq.

Armend Zemaj po pretendon se ia ka përmendur emrin, në përgjegjësi publike le ta marrë fjalën, në qoftë se iu ka përmendur emri. Regjia, jepja fjalën, replikë!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Po, ma ka përmendur emrin, Armend, unë e kam emrin, mbiemrin nuk ma përmendi, po Armend jam unë këtu, i vetëm dhe po e saktësoj për çka e pati fjalën. E para, zëvendëskryeministri kur të flasë për këtë procesin dialogues, duhet ta ketë edhe bashkëdrejtuesin për të qenë në plotni, të cilin nuk e ka sot këtu, e dyta, vetëm një pjesë ke këtu e sinqertë, e të cilën e përmendi kryeministri që tha “deri pasdite i bëjmë deputetët dhe mund t’i kemi votat, për shkak të mungesës së votave”. Pra, kryetar, po bëni shkelje të Rregullores, këtë e di edhe zëvendëskryeministri Limaj, sepse rezoluta nuk është obliguese, s’ka qenë asnjëherë, e shpreh vullnetin e Kuvendit, por nuk është obliguese. Nuk kemi Delegacion Shtetëror me ligj, dhe për këtë arsye ne po kërkojmë saktësim dhe respektim të plotë të Rregullores së punës së Kuvendit, kaq!

KRYETARI: Para se ta marrë fjalën Glauk Konjufca, për hir të opinionit publik, asnjë shkelje procedurale nuk është duke u lejuar dhe në momentin që vjen deri aty, nuk do të lejoj vendimmarrje. Për të folur, ky është Parlamenti. Urdhëro, zoti Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Prej diskutimeve të deritashme po nënkuptohet sikur kjo është një çështje shumë e ndërlikuar, por unë mendoj që është edhe më e ndërlikuar se kaq sa po flasim. Domethënë, po jap një kontribut që ta ndërlikoj edhe më shumë këtë problematikë, sepse mendoj që nëse e themi të vërtetën deri në fund, e këtu nuk po shpalosen të gjitha dimensionet e saj, ma merr mendja që është shumë më dramatike dhe shumë më paradoksale se kjo që po e flasim. E para, kryeministri ma merr mendja as që është dashur ta thërrasë këtë seancë, për arsye se kryeministri është tërhequr prej dialogut me Serbinë, ndoshta këtë mbledhje është dashur ta thërrasë Fatmir Limaj, që është zëvendëskryeministër, por jo kryeministri, i cili faktikisht, po s’ka drejtë, po, po e them me ironi, por jo Kryeministri i Kosovës, i cili faktikisht është tërhequr prej dialogut me Serbinë.

E dyta, paradoksi tjetër është tërhequr prej një rezolute të Kuvendit të Kosovës, mirëpo më 13 dhjetor e ka prezantuar qysh do të duhej të dukej marrëveshja me Serbinë. Kjo është shumë e rëndësishme, e kemi harruar këtë pjesë, mirëpo Kryeministri i Kosovës, të mos harrojmë këtë fakt shumë të rëndësishëm, më 13 dhjetor e ka paraqitur një tekst goxha të gjatë, i cili është marrëveshja me Serbinë, si do të duket marrëveshja me Serbinë. Mua ma merr mendja që ajo është shumë më e rëndësishme se platforma, se është vizioni i kryeministrit qysh do të duket marrëveshja me Serbinë. Tash, pyetja ime që dua ta shtroj unë është kjo: çka ka ndodhur me atë marrëveshje me Serbinë, e cila është prezantuar prej kryeministrit. Kryeministri ende nuk ka dalë në publik që të na tregojë a është tërhequr prej atij dokumenti, sepse nëse nuk është tërhequr, kryeministri më 13 dhjetor që e ka prezantuar atë dokument, unë mendoj që çështja këtu merr krejt drejtim tjetër.

KRYETARI: Glauk, a ka mundësi, se jemi duke hyrë në debat. A hyjmë në debat, se tashmë hyre në debat?

GLAUK KONJUFCA: Jo, jo, kjo është për procedurë.

KRYETARI: Ani, vazhdo, po hyjmë në debat, për hir të opinionit publik.

GLAUK KONJUFCA: Po ngadalë, se procedura e ka një histori...

KRYETARI: Vazhdo, pra zoti Konjufca, po menjëherë, si ta kryejë, kryeministër, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: E dyta, unë mendoj që Delegacioni Shtetëror i udhëhequr prej zotit Limaj dhe zotit Shpend Ahmeti nuk e ka asnjë kompetencë.

Po jo, kjo është. Nuk jam duke folur për platformë. Jam duke folur për Delegacionin Shtetëror. Këta asnjë kompetencë nuk e kanë. Edhe paradoksi tjetër është që, që po e zëmë që miratohet platforma. Hajde po e fantazojmë, që krijohen kushtet, debatojmë, kryhet debati, edhe miratohet platforma. Qysh mund të miratoni platformë të një delegacioni, i cili nuk e ka asnjë kompetencë? Delegacioni Shtetëror i Kosovës i merr kompetencat sipas ligjit. Ligji ende nuk është miratuar. Ju jeni një trup politik, i cili në Republikën e Kosovës jeni institucioni i vetëm, i cili nuk e keni asnjë kompetencë. Në mënyrë ligjore kështu i bie Fatmir. Shumë e vërtetë është kjo.

Në Republikë të Kosovës është krijuar një trup pa pasur kompetenca ende. Kjo askund në botë nuk ndodh. Njëherë është dashur të miratohet ligji, ligji i cili e themelon trupin, e pastaj trupit i jep kompetenca. Ju tash jeni si delegacion shtetëror i Kosovës, por keni vendosur që vetes t'ia bëni kompetencat me ligj, apo jo? Nëse keni vendosur kompetencat t'ia bëni me ligj, ky ligj ende nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Kështu që tash paradoksi është ky.

Që po e zëmë që u miratua platforma, që po e çoj dorën edhe unë. U miratua platforma. Qysh të miratohet platforma e një trupi, i cili nuk e ka asnjë kompetencë? Është e pamundshme. Këtu duhet të ndërpritet diskutimi menjëherë.

KRYETARI: Kryeministri i Republikës së Kosovës.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: A mos e keni edhe një minutë durim, veç?

Me leje, unë mendoj kështu Glauk, se ju me të drejtë e shtruat çështjen e marrëveshjes të Qeverisë, mirëpo nëse bën, do të thotë marrëveshja është hartuar në një kohë kur ende Parlamenti s'i ka pas marrë veprimet e veta. Pra, në Parlament ju ende s'keni vendosur ta votoni një delegacion. Si e tillë, marrëveshja është punë e Qeverisë, pra një potencial marrëveshjeje, një

draft-marrëveshje e kemi quajtur bazë. Mirëpo, pas një kohe të caktuar, kompetencat për temën i ka marrë Parlamenti. Pra kompetencat për dialogun, me votimin e delegacionit.

Tash i bie që unë i nënshtrohem vendimeve të Parlamentit, edhe Presidenti, edhe Kryeparlamentari, edhe të gjithë të zgjedhurit. Edhe e kemi kthyer temën te ju. Për këtë arsye mendoj që edhe diskutimet e juaja të sotme në Parlament, me gjithë vërejtjet potenciale, qoftë në përbërjen e delegacionit, qoftë në ligjin, qoftë në platformën, nuk mendoj se janë humbje kohe. Pra, diskutimet e juaja, qëndrimet e juaja për temën. Edhe ju kisha lutur, ne meqë kaluam në debat pra, jepini mendimet tuaja për materien, jepini mendimet tuaja për ato që janë. Shikoni, koha është e çmueshme për të gjithë, jo veç për neve që jemi këtu dhe ju siguroj që nuk është kjo ndonjë agjendë e fshehtë apo e ulët, a diçka për ta mashtruar Kosovën, por në fakt është tamam të diskutohet këtu ku është vendi për temat më të rëndësishme që i kemi për ne, edhe mendoj që edhe LDK-ja nuk kanë arsye ta lëshojnë sallën, kur është duke u folur tema më e ndjeshme, më e rënda që e kemi para vetes. Unë mendoj që është mirë të gjithë t'i thonë ato që kanë për t'i thënë, në fund pjesëmarrja në votim. Apo vendimet janë prapë të lira, askush nuk e ka obligative vendimin.

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj. Atëherë, zëvendëskryeministër futemi edhe në platformë. E ftoj Fatmir Limajn që ta paraqesë dhe arsyetojë platformën.

Zoti Molliqaj, para se të futemi, edhe z. Kuçi shpejt atëherë.

Zoti Limaj t'u kisha lutur që nëse e zgjatin më shumë, nëse s'përton të rrish aty. Urdhëro z. Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit zëvendëskryeministër,

Veç dy gjëra shumë të rëndësishme. Po supozojmë se shkuan këta, po për opinionin publik. Po supozojmë që s'ka as ligj, as delegacion. A duhet të kemi Platformë? Pra s'ka ligj për delegacionin, s'ka hiç delegacion shtetëror, por udhëheq Kryeministri ose Presidenti, s'ka rëndësi kush, platforma nuk është e lidhur me këtë punë. Edhe janë duke mashtruar kur po thonë platforma. A e dini cila është e vërteta pse s'po duan këta sot? Se këta po e dinë që më së shumti mund ta shtyjnë pesë ditë, se shmangia është për pesë ditë çështje. Këta nuk po duan të miratohet as ligji, e as platforma, për një arsye të thjeshtë, se në fund të kësaj jave, nesër, dhe në fillim të javës tjetër vijnë përfaqësues nga dy shtete të rëndësishme, Gjermania dhe SHBA-të. LDK-ja në veçanti po do të thotë që vendi nuk është stabil dhe duhet të bëhet një qeveri gjithëpërfshirëse për të hyrë në të. Kaq e thjeshtë është kjo farë situatë. Pra, këta janë duke e shtyrë për pesë ditë, për interesa partiake, që është në rregull, por proceduralisht s'kanë të drejtë, për këtë arsye edhe ikën.

KRYETARI: Blerim Kuçi të lutem, veçse e kemi zëvendëskryeministrin.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Po tash ishte një replikë me z. Shala, nënkryetarin, për procedurë. Procedura është shumë e thjeshtë, kategoria kushtetuese me Kushtetutë është portë hyrëse për këtë seancë të jashtëzakonshme, neni 69. Ka mundur të thirret një seancë e jashtëzakonshme për 17 pika. Pika e parë u eliminua për shkak të procedurës për shmangie nga Rregullorja, edhe duhet të shkojmë më tutje.

Kryetar, veç sqaroje si procedurë a jemi në rregull? Normalisht që jemi në rregull, por në moment kur një nënkryetar i Kuvendit thotë procedura nuk është në rregull, ju jemi të obliguar të merrni sqarimet e nevojshme, edhe të themi jemi në rregull. Ne jemi në rregull edhe me Kushtetutë, edhe me Rregullore, vazhdojmë më tutje. Nuk mund të them më shumë sesa të sqaroni procedurën ju edhe për opinionin publik.

KRYETARI: Faleminderit, z. Kuçi!

Proceduralisht keni parasysh, çdo veprim të cilin jemi duke e bërë deri tani është në rregull, është në respektim të Kushtetutës, Rregullores së Kuvendit dhe nuk do të lejojë asnjë shkelje proceduralisht. Kjo çështja e vendimmarrjes i takon seancës kur janë 61 deputetë. Platforma ka ardhur më 19 shkurt në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kijeni parasysh. Edhe proceduralisht i plotëson edhe kushtet për t'u trajtuar në seancë. Të jemi më i drejtpërdrejtë. Në vendimmarrje pastaj, në momentin duhet të jenë 61 deputetë që marrin vendime. Kjo është ajo të cilën duhet ta them.

Do të thotë, për hir edhe të opinionit publik, ne ishim si, kisha dëshira t'i jepja mundësi debatit, që të shterohet në Kuvend, por proceduralisht s'kemi pasur nevojë të flasim gjithë këto gjëra deri tani fare hiq, edhe të futemi drejtpërdrejt aty ku është zëvendëskryeministri për ta paraqitur platformën.

I nderuar zëvendëskryeministër, kemi dy deputetë të cilët po insistojnë në qoftë se e marr mirëkuptimin tuaj? Urdhëro! Le të flasë, po, pastaj e merrni fjalën si deputetë. Atëherë faleminderit deputetëve që e kanë kërkuar fjalën.

E vazhdojmë pastaj. E ftoj zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj që ta paraqesë dhe arsyetojë platformën.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot kam nderin që para jush të paraqes draft-platformën e hartuar nga Delegacioni Shtetëror i Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë.

Më 15 dhjetor të vitit 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar Rezolutën mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Kjo rezolutë, përveç themelimit të Delegacionit Shtetëror, kërkon edhe hartimin e platformës së dialogut ku do të saktësohen të gjitha parimet udhëheqëse mbi të cilat Delegacioni Shtetëror do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në procesin e dialogut. Në përputhje me aktet e Kuvendit, Delegacioni Shtetëror do të raportojë dhe informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës për të gjitha çështjet me dialogun dhe sipas obligimeve të saj, sot në emër të delegacionit ia paraqesin delegacionit draft-platformën për ta miratuar:

Hyrje: Kosova është shtet i pavarur dhe sovran që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Menjëherë pas kësaj, me 9 shtator të vitit 2010, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e cila e kishte referuar çështjen në Gjykatën për opinionin e saj këshillëdhënës, mori parasysh vendimin e Gjykatës dhe e inkurajoi dialogun e ardhshëm mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, me qëllim të promovimit të bashkëpunimit midis dy shteteve. Progresi në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Në përputhje me këtë, Delegacioni Shtetëror i Kosovës e ka miratuar Platformën gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyruar për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Qëllimi i platformës është që të vendosë parimet kryesore, pozicionet dhe objektivat e përgjithshme të Republikës së Kosovës për procesin e dialogut me Serbinë. Temat e panegociueshme, të patjetërsueshme dhe të pakthyeshme për Republikën e Kosovës janë: statusi i Republikës së Kosovës si një shtet i pavarur sovran, në bazë të shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008 dhe vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare 2010; sovraniteti shtetëror dhe integriteti territorial i Kosovës është i panegociueshëm; Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila ka përfshirë obligimet e dala nga paketa e Ahtisarit, burimet natyrore, pasuritë dhe asetet të cilat janë në territorin sovran të Republikës së Kosovës, karakteri unitar i Kosovës, ku nuk mund të ketë një nivel tjetër të qeverisjes, përveç nivelit lokal dhe qendror.

Kjo platformë është e bazuar në këto parime:

Parimi i parë: Qëllimi kryesor i Republikës së Kosovës që nga Republika e Serbisë të sigurojë njohjen dhe pranimin e qartë të sovranitetit të Republikës së Kosovës si shtet i pavarur me zotime ligjërisht të detyrueshme.

A. Do t'i ndërpresë të gjitha aktivitetet që pengojnë Republikën e Kosovës në rrugën drejt njohjes ndërkombëtare si shtet i pavarur dhe sovran.

B. Të respektojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

C. Të heqë dorë nga kundërshtimi ose ndikimi mbi palët e treta që të kundërshtojnë çfarëdo aplikimi nga Republika e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe agjencitë e tjera ndërkombëtare.

D. Të heqë dorë nga të gjitha format e ndërhyrjes në çështjet e brendshme apo marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës beson se kjo është e vetmja mënyrë efektive për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve për të arritur progres në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve të dy vendeve tona, si edhe parashihet nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 9 shtator 2010.

Parimi 2: Nuk ka marrëveshje për asgjë, derisa të mos ketë marrëveshje për gjithçka. Siç është theksuar në parimin 1, njohja e ndërsjellë duhet të jetë rezultati primar i këtyre bisedimeve.

Parimi 3: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila ka përfshirë obligimet e dala nga Plani i Ahtisarit, nuk është e hapur për negociim. Ky plan shënoi përmbylljen e një procesi të negociatave të autorizuara nga Kombet e Bashkuara për statusin përfundimtar të Kosovës dhe mori përkrahjen e shumicës së bashkësisë ndërkombëtare si zgjidhje përfundimtare.

Plani shpreh në mënyrë eksplicite atë që kërkojnë nga të dyja palët për arritjen e një zgjidhje të drejtë, duke imponuar një seri koncesionesh mbi Republikën e Kosovës për ofrimin e garancive për të drejtat e komuniteteve në Kosovë, veçanërisht të komunitetit serb. Kosova ka zbatuar me përkushtim të gjitha dispozitat e Planit të Ahtisarit.

Parimi 4: Objektivat politike të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut synojnë zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, duke përfshirë:

a. Heqjen e të gjitha pengesave të mbetura ndaj ushtrimit të pavarur të kompetencave sovrane, të qeverisjes, në përputhje me parimin e mosintervenimit dhe mosndërhyrjes.

b. Avancimin e të drejtave të komunitetit shqiptar që jetojnë në Republikën e Serbisë, në reciprocitet të plotë me komunitetin serb në Republikën e Kosovës.

c. Promovimin e respektimit nga të gjitha palët e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe refugjatët së bashku me standardet përkatëse ndërkombëtare të qeverisjes demokratike, llogaridhënëse dhe transparente, dhe

d. Krijimin e mekanizmave të përshtatshëm për të adresuar krimet e luftës, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare përfshirë zbardhjen e fatit të të pagjeturve si dhe reparacionin.

Parimi 5: Marrëveshja përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërish e detyrueshme duhet të jetë e qartë dhe pa dykuptimësi. Përvoja tregon se qasja e dykuptimësisë konstruktive, ka rezultuar në zbatimin asimetrik të marrëveshjeve të arritura deri më tani. Kjo praktikë mund të rezultojë me stagnim dhe mosmarrëveshje eventuale.

Dialogu duhet të vazhdojë derisa të dyja palët të ndajnë një kuptim dhe interpretim të përbashkët të asaj se çfarë kanë rënë dakord.

Parimi 6: Çdo marrëveshje përfundimtare duhet të jetë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila parasheh që, sipas nenit 2, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë, po citoj: sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Integriteti territorial i Kosovës garantohet gjithashtu edhe nga e drejta ndërkombëtare.

Parimi 7: Në Republikën e Kosovës nuk mund të ketë një nivel tjetër të qeverisjes, përveç nivelit lokal dhe qendror. Republika e Kosovës është e përkushtuar për respektimin e dispozitave kushtetuese dhe Planit të Ahtisarit për bashkëpunimin ndërkomunal, por këto dispozita nuk mund të rezultojnë në një nivel tjetër të qeverisjes.

Parimi 8: Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e saj të drejta mbi burimet natyrore dhe asetet të cilat janë në territorin sovran të Republikës së Kosovës janë ekskluzivisht të Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht nuk janë të hapura për negociim.

Parimi 9: Për Republikën e Kosovës, marrëveshja përfundimtare, ligjërish e detyrueshme, hyn në fuqi vetëm pas plotësimit të kushteve në vijim: kur Serbia e ka njohur Kosovën si shtet i pavarur dhe sovran, kur referendumi për marrëveshjen e mbajtur në Kosovë, dhe kur marrëveshja është ratifikuar nga Kuvendet e të dyja shteteve.

Parimi 10: Para dakordimit mbi formatin dhe rrjedhën e procesit të dialogut, Republika e Kosovës do të kërkojë masa të ndërtimit të besimit nga Republika e Serbisë. Këto masa përfshijnë: zotimin që në kuadër të marrëveshjeve për të gjitha çështjet e tjera, delegacioni serb e ka autoritetin që të bie dakord për parimin 1. Zotimi nga Republika e Serbisë se do t'i ndërpresë

menjëherë të gjitha aktivitetet agresive që synojnë e pengojnë të minojnë njohjen e Republikës së Kosovë.

Parimi 11: Në ushtrimin e mandatit të tij, Delegacioni Shtetëror do të funksionojë në premisat si në vijim: transparenca, gjithëpërfshirja, qasja dhe angazhimi i vazhdueshëm për konsensus politik në një marrëveshje të mundshme.

Të nderuar deputetë,

Këto janë disa nga parimet, në fakt parimet e draft-platformës që po paraqesim para jush, natyrisht unë dua t'i përmendi edhe temat që synon Republika e Kosovës t'i ngre në bisedimet e mundshme Kosovë - Serbi.

Synimet kryesore të Republikës së Kosovës janë: të sigurohet tash njohja e shtetit të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran, të punohet në integrimin, të sigurohet anëtarësimi i Kosovës si anëtar i plotë i Kombeve të Bashkuara dhe të njihet nga pesë vendet e Bashkimit Evropian, të synohet anëtarësimi në OSBE, në Këshillin e Evropës, në NATO dhe në fund në Bashkimin Evropian.

Ne do të ngremë tema të sigurohet drejtësi për krimet e luftës të shkaktuara nga Serbia, të sigurohet kompensim për diskriminim shoqëror, dëmet ekonomike, shkatërrimin e pronave publike dhe private nga Serbia, të avancohen të drejtat e komunitetit shqiptar në Serbi në reciprocitet të plotë me komunitetin serb dhe ajo që besoj është shumë me rëndësi që deri më tani nuk është ngritur, janë temat të cilat do t'i ngremë gjatë diskutimit. Dëmshtëpërblimet e luftës, mekanizmi i kompensimit të viktimave të luftës, zbardhja e fatit të personave të pagjetur, drejtësi për viktimat e dhunës seksuale, kthimi i pronës, kthimi i qytetarëve në pronat e tyre dhe po ashtu përgjegjësia penale për krime të luftës.

Është e papranueshme që deri më tani vazhdojmë të kemi problemin tash e 20 vite, çështjen e personave të zhdukur. Ne besojmë që Serbia, shteti serb i cili ka qeverisur juridikisht dhe faktikisht këtë territor një kohë të gjatë, ai i ka informacionet dhe ka përgjegjësinë si shtet t'i hap arkivat shtetërore ushtarake-policore dhe të zbardhë fatin e të zhdukurve, që besojmë që aty fati i njerëzve të pagjetur të Kosovës është dhe mund të zbulohet në arkivat shtetërore serbe. Prandaj do të kërkojmë përfundimisht që kjo çështje jo thjesht të jetë vetëm humanitare, por duhet të jetë në marrëveshjen gjithëpërfshirëse, kusht e një marrëveshje të mundshme Kosovë - Serbi.

Gjithashtu ne do të kërkojmë trajtimin, hetimin e të gjitha krimeve që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës, prandaj kemi kërkuar dhe do të kërkojmë në marrëveshje një trajtim të barabartë për të gjitha krimet që kanë ndodhur në Kosovë, pavarësisht kush i ka kryer, një trup ndërkombëtar i cili do të hetojë të gjitha krimet që janë kryer në Kosovë pa dallim etnie për t'i dhënë mundësi drejtësisë.

Të nderuar miq,

Edhe sot e kësaj dite fatkeqësisht me ata që kemi për të biseduar nga zyrat e tyre zyrtare, presidenti i Republikës së Serbisë, ministri i jashtëm i Serbisë, jo vetëm që s'kanë kërkuar falje, por vazhdojnë të mohojnë krimet e kryera në Kosovës. Hiq më larg se para dy javësh, Presidenti i Republikës së Serbisë në konferencën për shtyp edhe një herë mohon krimin e Reçakut, mohon të gjitha masakrat që janë kryer në Kosovë, vetë presidenti. Ne jemi të shqetësuar që s'kemi pasur një reagim nga Bashkimi Evropian dhe ne do të kërkojmë me zë nga Bashkimi Evropian që të deklarohet. Si mund të pretendohet futja e një vendi pjesë e Bashkimit Evropian? Si mund të bisedohen kapituj të ndryshëm me një vend i cili jo vetëm që nuk e pranon fajet dhe krimet që ka kryer, përkundrazi mohon dhe akuzon për konstruksion, për montazh për krimet që i ka kryer forcat serbe.

Për më tepër, ne jemi të shqetësuar dhe jemi skeptikë në dialogun e mundshëm kurdo që vjen me Serbinë, për faktin që duke parë që aktualisht në Serbi është rikthyer në tërësi makineria luftënxitëse e Milosheviqit në të gjitha strukturat shtetërore, nga kreu e të gjithë administratën. Diskursi politik në Serbi dhe publik është glorifikimi i krimeve dhe luftërave që ka zhvilluar makineria e regjimit serb. Kemi të bëjmë me një udhëheqje shtetërore serbe e cila nuk pranon vendime gjyqësore, përkundrazi i mohon, ose i injoron vendimet gjyqësore. Me vetë faktin që kriminelët e dënuar me vendime të prera të gjykatave ndërkombëtare sot kanë pozicione të rëndësishme në shtetin serb.

Aktualisht nuk është bërë asnjë hap në pastrimin e strukturave kriminale të trashëguara nga regjimi i Milosheviqit siç janë shërbimi sekret, policia, ushtria vazhdojnë sot të kenë rolin kryesor dhe zhvillojnë dhe ndërtojnë politika destabilizuese në rajon, e posaçërisht në Kosovë.

Të gjitha këto janë qartë që bëhen nën drejtim edhe të presidentit dhe ministrit të jashtëm të cilët kanë në krye njerëzit që janë të akuzuar dhe të gjykuar dhe për më tepër drejtues që mohojnë masakrat dhe krimet që janë kryer në Kosovë. Imagjinoni sot presidenti i një vendi i cili ka hapur negociata me Bashkimin Evropian del në presidencën e tij dhe thotë masakra e Reçakut është një krim i montuar nga shqiptarët dhe ndërkombëtarët për të bombarduar Serbinë. Presidenti i një vendi. Ministri i Jashtëm së bashku me njeriun që akuzohet edhe për udhëheqjen e operacionit në Reçak, edhe për vrasjen e vëllezërve Bytyçi, Goran Radosavljeviqi, së bashku me ministrin e jashtëm dalin në opinionin publik dhe sqarojnë dhe tentojnë t'ua mbushin mendjen njerëzve sesi masakra e Reçakut ka qenë një montim ndërkombëtar, një konspiracion kundër Serbisë.

Po i përmendi këto për të treguar që koha është që ne me zë të fuqishëm të ngremë çështjet, t'i adresojmë problemet me të cilat besoj që duhet të merret vendi ynë dhe përfundimisht t'i japim mundësi një dialogu të mirëfilltë, i cili do të mund të mbyllte të kaluarën, por jo duke glorifikuar regjimet kriminale.

Ne si delegacion shtetëror, të nderuar kolegë deputetë, besojmë që është një temë tepër me rëndësi, tepër e nevojshme. Kosovës i duhet dialogu. Kosova nuk duhet t'i ikë dhe nuk do t'i ikë asnjëherë tavolinës së bisedimeve, kurdo që ato do të zhvillohen. Parimet të cilat i paraqita para jush do të jenë udhërrëfyes i Delegacionit Shtetëror. Ne do të vazhdojmë t'ju informojmë sipas obligimit që kemi marrë para Parlamentit të Kosovës, qoftë në komisionin e veçantë, qoftë këtu në seancë plenare, me qëllim që procesi i dialogut të jetë plotësisht transparent dhe në përputhje me detyrat dhe obligimet që do t'i marrim nga Parlamenti i Kosovës.

Unë ju ftoj që me shumë seriozitet të kuptojmë peshën dhe rëndësinë e këtij momenti të rëndësishëm që Kosova e ka. Kosova duhet t'i përgjigjet dialogut dhe ta ruajë me plotë kuptimin e fjalës, me konstruktivitet dhe gatishmëri të futet në këtë proces. Është në interes të dy vendeve tona, është interes i regjionit që ne ta përmbyllim këtë temë, por duke respektuar njëri-tjetrin. Ne shkojmë në Bruksel jo për të negociuar shtetin tonë. Ne shkojmë në Bruksel për ta riafirmuar dhe fuqizuar shtetin tonë. Ne shkojmë në Bruksel për t'i dhënë mundësi paqes në regjion. Ne shkojmë në Bruksel për të gjetur rrugët e fillimit të ndërtimit të bashkëpunimit të regjionit dhe shkojmë në Bruksel për t'u dhënë mundësi dy vendeve tona, popujve tanë për të shkuar drejt integriteteve evropiane si interes strategjik i dy vendeve tona.

Në këtë drejtim, ne nuk duhet të hezitojmë dhe nuk duhet të vëmë asnjë pengesë për t'u ulur në tavolinën e atyre bisedimeve. Jam i bindur që Kosova në dialogët e deritanishëm, po flas Rambujeja, Vjena dhe kjo që mund të fillojë tani, janë dialogë në të cilët ka ditur të nxjerrë më të mirën për vendin e vet. Shpresoj dhe jam i bindur me unitet ne do të mund të dalim faqebardhë dhe nga ky proces dhe përfundimisht ta mbyllim këtë çështje.

Ne i ftojmë të gjitha grupet politike që t'i bashkohen kësaj platforme. Siç e keni parë dhe e patë ju, këto janë shqetësimet e të gjitha grupeve parlamentare të paraqitura për muaj të tërë. Nuk ka asnjë arsye që deputetët sot të mos marrin pjesë aktive në diskutimin e kësaj platforme dhe të votojnë platformën.

Refuzimi për të diskutuar për një platformë e cila qartësisht është mbështetje për Republikën e Kosovës, atëherë tregon synimet tjera përveç asaj që është mbrojtja e interesit të vendit.

Të nderuar deputetë,

Pas diskutimit që do të këtë ju ftoj që të votohet kjo platformë dhe përfundimisht Kosova ta ketë një pozicion zyrtar në dialogun e mundshëm me Serbinë kurdo që ai do të vijë. Faleminderit shumë që na e dhatë mundësinë ta prezantojmë draftplatformën, nënkryetar.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Limaj! Në emër të grupeve parlamentare fjalën e ka zoti Memli Krasniqi. Në emër të komisionit kush e ka? Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit.

Draftplatforma për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë iu është shpërndarë deputetëve më datë 19. 2. 2019.

Për këtë platformë, Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike është ngarkuar si Komision Funkcional për ta shqyrtuar dhe që Kuvendit t'i paraqesë raport me rekomandime lidhur me të.

Komisioni ka shqyrtuar dhe ka debatuar lidhur me platformën në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2019.

Në mbledhjen e mbajtur më 6 mars 2019, komisioni konstatoi se Republika e Kosovës duhet ta ketë platformën e saj shtetërore, ku saktësohen të gjitha parimet udhëheqëse mbi të cilat Delegacioni Shtetëror do të përfaqësojë Republikën e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë, dhe i rekomandoi Kuvendit ta miratojë draftplatformën për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Andaj, i ftojme deputetët që ta votojnë këtë platformë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në këtë sallë dhe jo vetëm në këtë sallë është diskutuar gjerë e gjatë dhe shumë herë për dialogun me Serbinë. Me të drejtë është thënë që një nga çështjet kyçe, dhe tash u tha, dhe sigurisht që do të thuhet gjersa të përmbillet, një nga çështjet kyçe që e presin e këtë Kuvend dhe këtë shtet është finalizimi i dialogut me Republikën e Serbisë. Me qëllim të vetëm, njohjen e ndërsjellë në territorin që është i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve dhe angazhimeve, jo vetëm këtu, po në çdo rast dhe çdoherë është kërkuar që Kuvendi i Kosovës të ketë rolin e tij. Është për të çuditur që pikërisht ata që

kanë qenë më të zëshëm, pikërisht ata që kanë kërkuar që të mos monopolizohet ky dialog, janë kundër platformës dhe kundër projektligjit.

Mendoj që qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojnë qartë dhe besoj që e kanë saktësisht të qartë, se kush është që Kuvendi i Kosovës të ketë rol kyç në këtë dialog.

Projektligji për Delegacionin Shtetëror është një projektligj që për herë të parë e përcakton qartë, ia përcakton qartë kufizimit secilit qytetar të këtij vendi dhe secilit pjesëtar të këtij vendi, edhe vet Delegacionit Shtetëror se çfarë mund të vendos në emër të Kosovës në këtë dialog.

Nga ky projektligj, që do të shndërrohet në ligj shumë shpejt, pas një dite, sot ose pas pesë ditësh, buron e drejta e Delegacionit Shtetëror dhe obligimi njëkohësisht për ta sjellë një platformë që është gjithëpërfshirëse dhe që dëshmon se ky delegacion shtetëror e ka seriozisht këtë çështje, të cilën ia ka ngarkuar Kuvendi pas rezolutës së votuar.

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar më vëmendje, e ka analizuar dhe e mbështet plotësisht, dhe jo vetëm që e mbështetë, por në kuadër të kësaj platforme do të kërkojë përgjegjësi ndaj Delegacionit Shtetëror për çdo hap dhe për çdo veprim të cilin do ta ndërmarrin.

Kërkon atë çfarë është e përcaktuar qartë dhe që është e dëshmuar në këtë platformë dhe e cila sigurisht që do ta marrë mbështetjen e këtij Parlamenti. Pra, do të kërkohet që t'i përmbahet saktësisht çdo veprimi dhe çdo vendimi që buron nga kjo platformë dhe nga projektligji i cili do të shndërrohet në ligj.

Ne si deputetë si të zgjedhur të popullit duhet të jemi shumë koshientë në këtë aspekt. Për herë të parë ne po diskutojmë para se të përmbillet një çështje dhe në kuadër të kësaj duhet ta kemi parasysh, që edhe qytetarët tanë po edhe miqtë tanë dhe të gjithë janë të interesuar që ky dialog të përmbillet.

Nuk dua tash të bëj analiza gjeopolitike, gjeostrategjike, po është interesi i vendit që dialogu të finalizohet. Nuk kuadër të kësaj, grupi ynë parlamentar do të ofrojë mbështetjen e gjithanshme dhe të vazhdueshme që kjo platformë të jetë e realizueshme në përpikëri.

Dua ta them edhe një fjalë për fund, ne në komision parlamentar e kemi diskutuar dhe opozita ka pasur mendimin e vet për platformën. Është shumë e domosdoshme dhe do të ishte patjetër e nevojshme që të njëjtat qëndrime të cilat i ka mbajtur aty t'i mbajë edhe këtu, dhe t'i ofrojë opinionit të gjerë ato çfarë kanë për t'i ofruar.

Normalisht që qytetarët tanë ta vlerësojnë pastaj se a është krjet formale kjo platformë. A është ky projektligj krejt formal apo është një nga platformat shumë të rëndësishme dhe një nga projektligjet shumë të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së, zoti Dukagjin Gorani.

DUKAGJIN GORANI: Të nderuar deputetë,

Ju ftoj që sot të vendosni për mënyrën e përfaqësimit të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut.

Të vendosni për qasjen negociuese për parimet udhërrëfyese dhe për synimin politik të shtetit tonë në këtë përpjekje. Këto janë të përmbledhura sot para jush në formë të dy propozimeve; të projektligjit dhe të platformës për dialogun.

Qëllimi i projektligjit është përcaktimi dhe saktësimi i mandatit të Delegacionit Shtetëror në proces. Qëllimi i platformës është përkufizimi i parimeve politike, i interesit shoqëror dhe i synimit shtetëror të Kosovës në të.

Mbi të gjitha, shpresoj që përmbajtjen e këtyre dokumenteve do ta kuptoni si reflektim i kompromisit ndërpartiak e parlamentar gjatë krijimit të tyre. Ajo reflekton raportin aktual të forcave politike në Kosovë dhe nivelin aktual të gatishmërisë partiake për ta kuptuar seriozitetin e përballjes që e pret shtetin tonë.

Duke qenë propozuese e njërit prej këtyre dokumenteve, Partia Socialdemokrate është përpjekur ta hartojë një rrugëdalje procedurale në situatën e dhënë, atë të polarizimit të vazhdueshëm brenda-qeveritar dhe të përplasjeve të pafundme ndërpartiake.

Kjo për faktin se situata e tillë megjithatë nuk ndryshon një fakt politik për të cilin besoj që vazhdojmë të pajtohemi të gjithë. E ai është se dialogu është proces i pashmangshëm i cili patjetër duhet të rifillojë dhe patjetër duhet të përmyllet ashtu që të mund t'i hapet rruga përqendrimit shtetëror për zhvillim shoqëror.

Andaj, nëse si proces është i pashmangshëm edhe rrugëdalja nga ngecja e deritashme, duhet të shihet si e domosdoshme.

Sikurse projektligji ashtu edhe platforma për dialogun janë reflektim i mundësive reale ekzistuese për veprim negociator brenda situatës aktuale, si në këtë Kuvend ashtu edhe në rajon edhe në botë.

Këto janë dokumente të përpiluara në një kohë të mosdurimeve lokale. Të provokimeve rajonale dhe të paqartësive ndërkombëtare. Janë të hartuara në kulmin e spekulimeve dhe të shqetësimit shoqëror për ndarje të vendit. Për copëtim të territorit dhe rrezikim të mbijetesës shtetërore e kombëtare.

Andaj, shpresoj se hartimet e propozuara do t'i kuptoni dhe t'i interpretoni si përpjekje për krijim të siguresave procedurale dhe institucionale brenda një procesi të pasigurt dhe të vështirë.

Shpresoj t'i kuptoni si përpjekje e hartuesve të tyre që të arrijmë pajtueshmëri mes mundësive politike dhe shqetësimeve shoqërore. Që të vendoset një baraspeshë mes dëshirave partiake, ambicieve personale dhe realitetit parlamentar.

Përndryshe, ideale do të ishte ta kishim një Qeveri të shumicës e cila do ta udhëhiqte këtë proces me pajtueshmëri të plotë parlamentare, pro nuk e kemi. Ideale do të ishte ta kishim një president që do të ishim në gjendje që ta kuptojmë se për çfarë po flet, por nuk e kemi.

Mbase, ideale do të ishte që proces të dialogut ta shpërndajmë vetëm Kushtetutën e Republikës së Kosovës e jo ta dërgojmë ndonjë delegacion shtetëror, pro ja që nuk mundemi.

Kam frikë se pikërisht këto diskutime mbi situatat ideale e vonuan dhe e vështirësuan tej mase pranimin e gjendjes reale dhe aktuale në skenën tonë politike. Këto diskutime po e mundësojnë vetëm theksimin e vështirësive e jo edhe gjetjen e mundësive. Tash e sa kohë, ato janë shndërruar në diskutime për problemin e jo në përpjekje për zgjidhje.

Andaj sot, përtej elaborimit të rregullimeve ideale, duhet të përpiqemi të vendosim për atë që është optimale.

Sot, duhet ta marrim guximin që ta arrijmë emëruesin e përbashkët për qëllimin e përbashkët në një proces të përbashkët që ka ndikim të përgjithshëm. Jam i bindur se edhe projektligji edhe platforma për dialogun i ngërthejnë në vete në mënyrë të baraspeshuar edhe synimet tona shtetërore, por edhe shqetësimet shoqërore.

S'do mend, përmbajtja e këtyre dokumenteve është e ndikuar nga situata e pasigurisë politike dhe e drojës publike, por nuk është e mbizotëruar prej tyre.

Krejt në fund, këto dokumente duhet të interpretohen edhe si dëshmi e guximit të hartuesve të tyre që të marrin përgjegjësi për angazhimin publik dhe ta pranojnë domosdonë e bashkëpunimit politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Kadrijaj. Zonja Time, a dëshiron të flasësh?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar edhe projektligjin, po edhe platformën, dhe njëkohësisht gjatë trajtimit të dhënë edhe nëpër komisioni dhe kështu kemi bërë apel për konsensus dhe bashkëpjesëmarrje edhe nga deputetët e opozitës, sepse jemi në një situatë të ndjeshme. Jemi në një situatë ku vërtetë duhet ta gjejmë një konsensus dhe të jemi të bashkuar.

Andaj, kemi kërkuar që edhe ata t'i bashkohen këtij procesi; edhe procesit të dialogut, po edhe ta përkrahin platformën për bisedime. Pra, ne e kemi përkrahur dhe do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Në emër të Nismës i japim përkrahje, mbështetje platformës, platformë e cila në vetvete ngërthen të gjitha ato që në këtë debatin e ashpër publik, pothuajse një vit përfliten.

Janë përfshirë jo vetëm interesat e shtetit dhe interesat e qytetarëve por edhe shqetësimet e tyre nga frika që është përhapur në publik se qarkullojnë lloj-lloj idesh lloj-lloj projektesh, lloj-lloj skenarësh për gjoja ndarjen, copëtimin apo duke shkuar deri në skenarë të tillë ku parashihej edhe zhbërja e shtetit të Kosovës.

Pra, kjo platformë i jep përgjigje të gjitha atyre shqetësimeve dhe e kemi për detyrë, jo vetëm si deputetë të mazhorancës, por edhe deputetë të opozitës, qytetarët në përgjithësi që ta mbështetin.

Nuk është e udhës që të pritet shmangie nga tavolina. Shmangiet nga tavolina që shumëkush po i promovon nuk janë rrugë të duhura apo nuk është rruga e duhur për faktin se kush mungon aty ku flitet për të, zakonisht merren vendime shumë të këqija sesa kur je në tavolinë.

Pra, nëse deri më tani kemi kritikuar qasjen e shkuarjes në dialog me duar në xhepa, tash së paku ky format i dialogut, kjo fazë e fundit e dialogut nuk do ta lejojë delegacionin që t'i mbajë duart në xhepa, sepse do të kenë një letër në dorë. Do të kenë një platformë në dorë. Do ta kenë një dokument në dorë, të cilin do ta kenë për detyrë të shkojnë dhe ta mbrojnë atje.

Prandaj, duke u bazuar në këtë që u tha edhe nga bashkëkryesuesi i Delegacionit Shtetëror, zoti Limaj, u tha edhe nga kryetarët e grupeve parlamentare, përkatësisht përfaqësuesit e tyre, nuk na mbetet gjë tjetër pos t'i japim mbështetje dhe të kërkojmë që kjo çështje të hedhet në votim dhe ta marrë miratimin e Kuvendit dhe t'ju dalim zot detyrave të cilat i kemi marrë. Pra, t'i kryejmë

përgjegjësitë tona si Kuvend, në mënyrë që Delegacioni Shtetëror të jetë i pajisur me një dokument zyrtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, në emër të 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kolege të nderuara dhe kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të nderuar,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar 6+, po njëherësh edhe në emër të komunitetit rom, dëshiroj të shpreh qëndrimin tim lidhur me platformën për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Tanimë jemi të vetëdijshëm se jemi në fazën finale të bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Kuptohet që për secilin prej nesh kjo fazë është tejet e ndjeshme dhe domethënëse sepse ka të bëjë me të ardhmen e fëmijëve tanë e sidomos edhe për të ardhmen e shtetit Kosovës.

Prandaj, besoj që secili nga ne ka dhënë dhe është duke u përpjekur që të japë kontributin e tij sado të vogël për të arritur një rezultat të kënaqshëm për shtetin e Kosovës, e për këtë më së miri tregon krijimi i Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës, dhe platforma e saj për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve me të dy shteteve sovraane, e që personalisht mendoj se është gjëja më mirë që kanë mundur t'i ndodhë institucioneve të Republikës së Kosovës, e sidomos institucionit më të lartë të Kosovës, Parlamentit të Kosovës.

Platforma për dialogun së bashku me parimet e saj, mbi të gjitha tregon një punë të palodhshme dhe profesionale për të gjithë ata që kanë marrë pjesë në përpilimin e saj.

Kjo platformë në parimet e saj, para së gjithash, duhet të tregojë një qëndrim të paluhatshtëm të Delegacionit Shtetëror përballë Republikës së Kosovës. Ashtu siç edhe është thënë në parimin numër 1, qëllimi kryesor i Republikës së Kosovës duhet të jetë pranimi i detyrueshëm o sovranitetit të Kosovës si shtet i pavarur.

Gjithashtu, ajo me të cilën pajtohem sa u përket parimeve të kësaj platforme është adresimi i pesë shtyllave kryesore mbi përgjegjësinë penale dhe reparacionet për krime të luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Përgjegjësia penale për krimet e luftës. Mekanizmi i kompensimit

të viktimave luftës. Zbardhja e fatit e personave të pagjetur. Drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe kthimi i pronës.

Pra, siç e ceka edhe më lart, njoha e ndërsjellë si dy shtete sovrane dhe të pavarura duhet të jetë rezultat primar si dhe gjëja më e rëndësishme që duhet ta kemi parasysh është Kushtetuta e vendit, përkatësisht e Republikës së Kosovës, e cila nuk duhet të jetë e hapur për bisedime.

Çdo marrëveshje e arritur apo përfundimtare duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës në të kundërtën është dështim total.

Si Grup Parlamentar 6+, me mundësitë tona gjithmonë i kemi dhënë përkrahjen tonë Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në bisedime me shtetin serb, sepse besojmë në këtë delegacion shtetëror. Besojmë në përkushtimin dhe profesionalizimin, e sidomos besojmë në transparencën e delegacionit.

Gjithashtu, mendojmë që i vetmi mjet për të arritur paqen është dialogu.

Jemi të vetëdijshëm që këto bisedime të fazës finale me Serbinë janë të rënda dhe të vështira, por besoj që synimi ynë është që me këtë proces të bisedimeve të përmbyllet me një marrëveshje historike për shtetin e Kosovës, e që është njohja e shtetit të Kosovës nga shteti serb.

Besojmë që arritja e marrëveshjes me Serbinë është e domosdoshme në synimet e Kosovës që bëhet anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, integrim në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Por, gjithashtu dua ta ceku se jemi kundër çdo arritje të marrëveshjes apo ndonjë konsensusi që ka të bëjë cenimin e sovranitetit apo shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Prandaj, edhe njëherë krejt në fund, dua të them që plotësisht përkrahim Delegacionin Shtetëror të Republikës së Kosovës si dhe platformën për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Të nderuar kolegë të paktë në këtë seancë, Pikësëpari pyetja kryesore e cila duhet të na udhëheqë sot është; a ka Republika e Kosovës politikë të unifikuar shtetërore a jo? Pastaj do ta sqaroj pse e kam bërë pyetjen e parë.

Dhe nën dy, a ka unitet në Republikën e Kosovës për integritet territorial të shtetit tonë?

Ama unitet të vërtetë për integritet territorial, jo unitet para kamerave e pas dyerve të mbyllura të pranohet ideja e ndërrimit të territorit të shtetit tonë.

Tash, pse e bëra pyetjen e parë?

Në qoftë se sot votohet, pasi që të votohet ligji për delegacion shtetëror, nëse votohet platforma kjo do të thotë që Kosova e ka rrumbullakuar bazën e vet politike me vendimmarrje të Kuvendit, po pyetja mbetet te taksa. A ka nevojë për taksë a jo? Kjo është pyetja.

Nuk mund të votosh platformë edhe mandej të mbetesh në pozicion sikurse para platformës. Domethënë nuk mund të bëhet shaka me këto punë.

Tash, të dal te platforma për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirës dhe ligjërisht të detyrueshme e tjera.

Pikësëpari emrin duhet t'ia ndërrojmë kësaj. Në ligj për Delegacionin Shtetëror thuhet: Platforma shtetërore, aq shkurt. Këtu është tjetre dokument. Andaj, duhet të unifikohet edhe gjuha mes dyjave.

E dyta, platforma në lexim të parë siç kam thënë shumë herë duket shumë e mirë. Në lexim të dytë i sheh mangësitë dhe në të tretën i merr vërejtjet. Mua më vjen shumë keq që nuk kam pasur mundësi që t'i adresoj në diskutim me anëtarët e Delegacionit Shtetëror, vërejtjet të cilat i kam, e do t'i them sot këtu.

E para, prej 9 faqeve 4 janë të panevojshme. Nuk ka nevojë për 9 faqe platformë dhe shpjegime. Platforma është pozicion shtetëror, jo shpjegim.

E dyta, fryma e dokumentit është kontradiktore, do tua sqaroj pikë për pikë se ku është kontradiktore. Nuk mund të ketë kontradikta aq të mëdha brenda një dokumenti i cili synon të tregojë se këtu ka pozicion të unifikuar.

E treta, mungon baza e platformës. Baza e platformës është parimi i panegociueshëm i cili i jep frymë parime të tjera, dhe këtu po ju them qartë; parimi i panegociueshëm, në bazë të deklaramit të partive politike duhet të jetë ky; shkruhet parimi i paegociueshëm dhe nën të:

A, apo pika 1, është: duhet të jetë: pavarësia, sovraniteti, integriteti territorial i Republikës së Kosovës janë të panegociueshme. Pikë! Qe një parim i panegociueshëm.

E dyta: funksionaliteti institucional dhe shtetëror i brendshëm është i panegociueshëm. Qe, edhe përfundoj pika e mbrojtjes ku obligohen me vendim të Kuvendit anëtarët e delegacionit shtetëror që nuk do ta diskutojnë integritetin territorial sepse është e panegociueshme.

Rrjedhimisht me këto dy parime të panegociueshme, ndërrohen parimet e tjera të cilat janë në dokument.

Tash po dalim pikë për pikë. Në faqen 2, pika 2, ku shkruhet për marrëveshjen e parë të Brukselit. Këtu mungon vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Bashkësinë e komunave me shumicë serbe dhe mungon që nuk ceken 33 marrëveshjet të cilat janë nënshkruar me Serbinë dhe nuk ka përgjigje të Kosovës ato 33 marrëveshje të cilat nuk janë të zbatuara a do t'i adresojë në këtë dialogun përfundimtar apo duhet të adresohen paralelisht me këtë a para?

E dyta, parimi i parë duhet patjetër, në qoftë se mbetet i tillë, duhet të shtohet fjala integriteti territorial. S'mundemi ne të luajmë me fjalë dikush të thotë e mbrojmë sovranitetin e shtetit pa e përmendur integritetin territorial, nuk shkon njëra pa tjetrën dhe kjo është në kundërtënie me parimet e tjera më poshtë ku përmendet integriteti territorial.

Parimi i dytë, që thotë nuk ka marrëveshje për asgjë, derisa të mos ketë marrëveshje për gjithçka, duhet të jetë parim i parë, nëse shkohet në logjikë të parës. E para është kjo.

Parimi i tretë është i panevojshëm. Pse duhet ne të sqarojmë në parim që Kushtetuta, Plani i Ahtisarit e gjëra të tjera. Ato e heq me parime të panegociueshme. Nuk e përsëritim tri herë mbrojtjen, frikën prej mos po diskutohet për rrafsh të tretë e gjëra të tjera.

Parimi i katërt, nuk mund thuhet që objektivat politike të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut synojnë zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura me Republikën e Serbisë, pa i cekur cilat janë çështjet e hapura për neve me Republikën e Serbisë në kuadër të këtij parimi. D.m.th. duhet të jetë e cekur dhe mos harroni, ky parim i katërt duhet njëjtë të ceket që procesi apo si çështje e hapur është si të zgjidhet edhe fqinjësia e mirë që ne jemi të obliguar me MSA dhe Serbia është e obliguar me proces të akcesionit me BE-në. D.m.th. parimi i fqinjësisë së mirë edhe në bazë të dokumenteve ndërkombëtare të cilat janë valide për neve, edhe për Serbinë e në bazë të cilave Serbia e ka njohur integritetin territorial të Republikës së Kosovës, mos harro!

Pika a te parimi i katërt. Mendoj që është dhënë në mënyrë gjenerale ku thuhet heqjen e të gjitha pengesave të mbetura ndaj ushtrimit të pavarur të kompetencave të sovranit, të qeverisjes. Sepse, mos harroni, ne e kemi marrëveshjen e IBM-së, e cila me para të BE-së dhe me dokument të BE-së, është obligim për integritet, për mbrojtje të integritetit territorial të Kosovës. D.m.th. është marrëveshje edhe e sovranitetit. E kemi Gjykatën e cila funksionon me Kushtetutën tonë në veri. I kemi komunat të cilat funksionojnë pak a shumë, por prapë se prapë në ombrellën e kornizës

tonë kushtetuese. Doganat, policia. Ky është sovraniteti në ditë të sotme. Nuk është sovraniteti të çohemi ne t'u bëjmë zullum njerëzve. Sovraniteti në veri është a po funksionon shteti jonë? Po, po funksionon shteti jonë në bazë të këtyre parimeve.

Te pika b, është pak e nevojshme kjo punë, sepse është mbrojtëse, është defansive. Nuk mund të thuash ti, unë e kam mbërrirë këtë standard, por tash po kërkoj diçka tjetër, sepse vetëm e ke përmendur Ahtisari e gjëra të tjera.

Pika d. Kur thuhet krijimin e mekanizmave të përshtatshëm për të adresuar krimet e luftës, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare, mungojnë edhe klasifikimet e tjera dhe të cilat janë përmendur edhe në gjykimet e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ku janë pastrimi etnik, i cili është krim i luftës, nuk është vetëm e drejta humanitare, është edhe krimet e luftës, është edhe pastrimi etnik, e të tjera. D.m.th. duhet, jo duhet të ceket saktë. Nuk është këtu e njëjta.

Parimi i pestë, fjalia e dytë dhe e tretë janë të panevojshme. Çka po na vyen sqarim i tillë, këtë? Faktikisht parimi i pestë duhet të jetë realisht parim numër dy. S'ka dykuptimësi në marrëveshjet e ardhshme.

Te parimi i gjashtë, në qoftë se hyn te parimet e panegociueshme, i gjashti është i panevojshëm në këtë dokument.

Parimi i shtatë është i panevojshëm, sepse është i ngërthyer në parimin e tretë.

Parimi i tetë, ku thuhet që në përputhje me Kushtetutën dhe të ligjet e saj, të drejtat mbi burimet natyrore dhe asetet janë në territorin sovran të Kosovës. Në rregull. Por duhet që të përmendet edhe parimi i suksesionit. Ne kemi qenë pjesë përbërëse e një federate. Nuk është ajo vetëm që janë të panegociueshme, por ka të bëjë me parim të suksesionit dhe duhet të jetë këtu, jo në tekst më gjatë. 4.45 për qind është pjesa që na takon neve. Duhet të përmendet vendimi i GJND-së për pronën e Kosovës, edhe ajo është. Dhe mos harroni konstituivitetin të cilin e ka pasur Republika e Kosovës. Ti duhet të thirresh në një trashëgimi të cilën e ke, konstituive, me çka është validuar pavarësia jonë.

Gjithashtu duhet që të përmendet që asnjë vendim prej vitit 1989 deri në 99, i cili është marrë prej Republikës së Serbisë sa i përket Kosovës nuk vlen në këtë dialog. Pse? Sepse me të drejtë ndërkombëtare, vendimet e tilla janë të suspenduara. Keni harruar vendimin e UNMIK-ut, i cili nuk i merr për bazë çfarëdo vendimi prej marr...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Shtoja dy minuta!

ILIR DEDA: Ne e kemi vetë atë armë. Ato vendime janë të pavlefshme për Republikën e Kosovës, sepse është vendosur edhe me të drejtë ndërkombëtare prej UNMIK-ut si organ i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Edhe në fund, pasi që i kam veç dy minuta që më kanë mbetur, me çfarë parimi do të bëhet demarkacioni i kufirit me Serbinë. Edhe kjo duhet të jetë një prej parimeve të delegacionit shtetëror. Cili është parimi udhëheqës i joni, i cili e bën demarkacionin? Duhet t'i kemi të qarta. Kjo nuk përmendet ajo. Cilat kritere janë të vlefshme për ne, e duhet që të ceket, se pastaj po na dalin probleme të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Z. Enver Hoxhaj e ka fjalën. Zëvendëskryeministër.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Nuk dua të t'ju marrë shumë kohë, dua t'i them veç disa gjëra kryesore. Së pari mendoj që në 2018-ën, gjatë komplet 2018-ës, kur kemi pasur debatin për dialogun në këtë Kuvend të Kosovës, por edhe në jetën tonë publike, kryefjala ka qenë e kolegëve çka jemi në koalicionin qeveritar, por edhe të atyre që janë në opozitë, që duhet të jetë Kuvendi ai i cili duhet t'i japë drejtim këtij procesi. Unë mendoj që mosprania sot e kolegëve flet të kundërtën prej kërkesës që e kanë pasur.

Ne kemi miratuar si hap të parë një rezolutë e cila krijoi delegacionin shtetëror. Kemi lexuar në lexim të parë Ligjin për dialogun shtetëror, sot e kemi një platformë, edhe ideja e platformës ka qenë që realisht Kuvendi i Kosovës të jetë pikënisja dhe të jetë adresa e fundit sesi t'i qasemi dialogut me Serbinë. Unë e dëgjova me vëmendje z. Ilir Deda, mora shënime. Mora shënime edhe prej deputetëve të tjerë se çka folën deri më tash. Teksti i platformës është konciz. I ka 11 parime, të cilat, neve na e merr mendja që i përfshin të gjitha temat të cilat mendojmë që këto parime i përfshijnë të gjitha temat dhe pritjet që i kemi. Dokumenti kur është shkruar, është shkruar sa për deputetë të Kuvendit të Kosovës, sa për të qenë qëndrim zyrtar i Kuvendit të Kosovës dhe i shtetit të Kosovës, po nganjëherë është e vërtet ka formulime të tilla, të cilat për juve janë të njohura, por është edhe një qëndrim i joni zyrtar në raport me bashkësinë ndërkombëtare, në raport me partnerët ndërkombëtarë. Paragrafët që janë ndonjëherë të tepërt, e kanë idenë që ky të jetë dokumenti me shkrim zyrtar, kujt do të duhej t'ia japim, ta ndajmë me ta dhe i kemi ndarë me ta deri më tash.

Por, këtë platformë që e keni ju para jush në 11 parime, me dy-tre elementë se çka nënkupton normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi dhe sidomos pjesa e zbatimit të marrëveshjes së mundshme mes dy vendeve, është vetëm deklarimi i vullnetit tonë politik. Për të gjitha temat të

cilat do të ngriten në dialog, ne do të kemi dokumente të veçanta strategjike. Nëse temë do të jetë përlllogaritja e borxhit kombëtar të ish-Jugosllavisë dhe aseteve, duhet të kemi dokument të veçantë dhe duhet të kemi kalkulim të veçantë, a duhet ta hapim këtë temë, a nuk duhet ta hapim këtë temë, a fitojmë a humbim prej kësaj çështjeje? Do të thotë, çfarë po synoj të them është që ju e keni një platformë, por përveç platformës, ne si delegacion do të kemi dokumente të detajuara për çdo temë që do të duhet ta ngremë në dialog.

Por, pa e zgjatur shumë, mënyrën sesi po e shoh seancën sot, e kam përshtypjen që shqetësimi i disave nuk ka të bëjë me tekstin, por ka të bëjë shumë me procesin. Në jetën tonë publike dhe në Kuvend të Kosovës, të gjithë kemi thënë që parime kryesore janë njohja e pavarësisë, anëtarësimi në OKB, integrimi në BE e NATO, kompletimi i sovranitetit, ruajtja e integritetit territorial, mbrojtja e karakterit unitar. Që marrëveshja të jetë mbi të gjitha përfundimtare dhe të ndodhë dialogu në parimin e barazisë mes shteteve dhe reciprocitetin e detyrimeve dhe mbi të gjitha që marrëveshja të jetë në nivel të drejtës ndërkombëtare, po edhe t'i nënshtrohet votës së Kuvendit, po edhe përmes një referendumi.

Unë nuk shoh këtu dallim mes neve çka jemi në sallë dhe kolegëve që nuk janë në sallë që të merremi vesh për këto parime. Është punë më shumë e vullnetit politik. Po ashtu, nuk ka të bëjë me mospajtimet, por ka të bëjë me qëllimet e përbashkëta. Nëse ne në 2019-ën jemi të interesuar që ta mbyllim këtë temë, është mirë çdokush t'i japë mbështetje kësaj platforme.

Prandaj unë e shfrytëzoj rastin që t'i ftoj kolegët, t'i besojnë procesit, fillimisht t'i besojnë procesit. Nën dy, t'i ftoj kolegët që ta nxjerrim, ta japim maksimumin që ta përmbysim këtë temë me Serbinë. Ma merr mendja që gjëja e vetme që ndoshta kemi nevojë në 2019-ën, është një unitet politik. Dokumenti se si ne e kemi ofruar, parimet të cilat i kemi ofruar si delegacion shtetëror e kanë një qëllim madhor që të arrihet unitet edhe në mendim, edhe në veprim politik. Prandaj i ftoj çdokënd i cili është i interesuar që ta mbyllë këtë temë, të jetë pjesë e procesi. Është shumë me rëndësi që të jetë pjesë e procesit, meqë parimet, kërkesat, shqetësimet të cilat i kanë pasur besoj që janë në këtë dokument.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Blerta Deliu.

BERTA DELIU-KODRA: Faleminderit i nderuar nënkryetar Haliti!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht që në fillim të fjalës time po e bëj të qartë atë që është rast i mirë që ne sot e kemi para vetes një platformë, ndonëse në kushte jo të duhura dhe me mungesë të opozitës, e cila sot do të duhej që të ishte pjesë e Kuvendit dhe ta thoshte qëndrimin e saj lidhur me platformën për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Mendoj që është një momentum i ri dhe shumë i rëndësishëm për të mbyllur çështjet e hapura në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Pothuajse në të gjitha takimet dhe forumet ku jemi bashkë me anëtarët e Komisionit për Integritet na kërkohet dhe janë mesazhe të qarta që Kosova dhe Serbia t'i mbyllin kapitujt dhe temat e rëndësishme me njëra-tjetrën, në mënyrë që Ballkani Perëndimor të dalë në një dimension tjetër sa i përket dy shteteve të cilat kanë kaluar periudha jo të mira me njëra-tjetrën.

Ajo që është thelbësore është që kjo platformë do të thotë krijon një pozicion të ri të Republikës së Kosovës dhe synim kryesor e ka që do të thotë arrijen e një konsensusi sa më të gjerë politik dhe të atij shoqëror në proces të dialogut me Serbinë. Ka një qëllim të qartë që Republika e Kosovës të njihet dhe të sigurojë njohje nga Serbia, duke krijuar njohjen e sovranitetit të Kosovës si shtet i pavarur me zotime të cilat janë të obliguara me Kushtetutë dhe me ligjet e Kosovës.

Marrëveshja përfundimtare duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të garantojë që nuk do të ketë Asociacion të komunave me kompetenca ekzekutive. Mendoj që është një bazë e mirë dhe i hap vendit perspektivë të qartë sa i përket angazhimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë.

Një element tjetër të cilin dua ta them është që platforma po ashtu fuqizon rolin e Kuvendit si institucion. Ka qenë kërkesë e përhershme e opozitës, si dhe e aktorëve të tjerë që Kuvendi të ketë një rol më të rëndësishëm në dialog dhe mendoj që me këtë platformë dhe me ligjin, Kuvendi e forcon rolin e tij mbikëqyrës sa i përket platformës, por edhe sa i përket mbikëqyrjes që do ta ketë në dialogun me Serbinë.

Një pjesë e opozitës do të duhej që t'i bashkohej delegacionit për dialog, sidomos tani kur po diskutohet për temën kryesore që është zgjidhja gjithëpërfshirëse dhe marrëveshja historike ndërmjet dy shteteve. Angazhimi dhe gjithëpërfshirja do të duhej që të ishin sa më të gjera, në mënyrë që Kosova të arrijë të flasë me një zë të qartë dhe me një zë më unifikuës. Mendoj që uniteti në dialog është nevojë thelbësore për të fuqizuar institucionet e Republikës së Kosovës dhe shtetin e Kosovës në dialog me Serbinë. Prandaj një pjesë e opozitës do të duhej që ta marrë rolin e tij që i takon në këtë proces të rëndësishëm dhe historik për Kosovën. Është kërkesë e përhershme e miqve tanë ndërkombëtarë që Kosova të arrijë ta përmbyllë këtë marrëveshje të rëndësishme, prandaj në fund konsideroj që opozita do të duhej që të bëhej pjesë, një pjesë e opozitës e cila ka abstenuar në këtë pjesë të grupit negociues ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të marrë rolin e saj që i takon dhe të mos abstenojë nga vendimi përfundimtar, që do të jetë një marrëveshje e rëndësishme për dy shtetet dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Z. Daut Haradinaj e ka fjalën. Atëherë, a është Dauti këtu?

DAUT HARADINAJ: Faleminderit kryesues!

Kërkoj falje për vonesën,

E para që unë kisha thënë edhe që mendoj që shumica prej deputetëve që janë këtu e përsëritën, për herë të parë prej vitit 2011 ne veç e kemi tash edhe një platformë, por e kemi edhe një ligj i cili u jep përgjegjësi dhe kompetenca delegacionit shtetëror të Kosovës e që është votuar pikërisht në Kuvendin e Kosovës. Meqenëse jemi duke folur te platforma, unë desha të them dy fjalë krejt ndryshe. E para po bëhet një presion shumë i madh për taksën, si kusht për fillimin e dialogut, ndërsa Kosova nuk e qiti kusht dosjen e të pagjeturve, ku janë rreth dy mijë shqiptarë, d.m.th. ku i kanë lënë. Kosova nuk qiti kusht pse nuk dorëzohen kriminelët të cilët i vranë vëllezërit Bytyçi, ose për masakrat e shumta. Kosova nuk qiti kusht kush e bëri krimin Panda në Pejë, ku u vranë shumë të rinj serbë e në anën tjetër u torturuan qytetarë shqiptarë që sot e kësaj dite janë nëpër spitalet psikiatrike. Pra, si rezultat i krejt kësaj, ne sot e kemi platformën ku janë të specifikuar përgjegjësitë e delegacionit shtetëror, dhe mendoj që Parlamenti i Kosovës duhet t'i japë mbështetje duhet t'i japë besim dhe përfundimisht edhe të arrihet rezultati për të cilin jemi nisur në këtë drejtim, pra le të arrihet marrëveshja finale me njohje reciproke, po në ët njëjtën kohë edhe të dihet fati i të pagjeturve tanë. Të dihet fati i përgjegjësive nga 2011-ta e deri më tani, ku kemi me dhjetëra marrëveshje dhe shumica nga to nuk janë implementuar nga ana serbe, përkundrazi kemi vetëm pasur probleme.

Në pjesën veriore vazhdojnë të jenë prezentë në mënyrë permanente instrumentet Serbisë, ndërsa Kosovës i bëhet presioni i pareshtur në raport me taksën.

Ne e dimë që e kemi pasur një marrëveshje ku Serbisë i pamundësohet ose i ndalohet lobimi kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata të ndryshme, por përkundrazi kishim një fushatë tepër agresive kur ishte rasti i anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Pra, edhe delegacioni i Kosovës duhet të fillojë që ta ngritë zërin paksa në raport me Serbinë.

Nëse ata na qesin kushte neve, duhet të mendojmë edhe ne që t'ju qesim kushte atyre, sepse kemi shumë argumente, shumë të drejtë, qoftë nga e kaluara po edhe nga e tashmja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

E para, dëshiroj të them që e shpreh protestën time të thellë ndaj mënyrës sesi po i udhëheqë seancat e Kuvendit të Republikës së Kosovës kryetari Kadri Veseli.

Përpos që po na lëshon "xekrra" në Kuvend e po ndez debate lidhje-palidhje është duke na diskriminuar në mënyrën sesi po na e jep fjalën.

Kam qenë nga deputetët e parë që e kam kërkuar sot fjalën dhe nuk ma ka dhënë qëllimisht. Arsyeja ka qenë se kam dashur që ta shpreh gjithashtu shokimin dhe protestën time për mbajtjen e kësaj seance Natën e Zjarreve.

Qysh i kam thënë atë ditë opozitës që ka qenë turp që kanë thirr seancë me datën 5 mars, po them që është turp sot për Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të thërrasë seancë Natën e Zjarreve. Dot të thotë e kanë futur në penal kryeministrin, por për dallim që 44 deputetë që kanë nënshkruar dhe kanë thirr seancë të jashtëzakonshme, atë ditë në Parlament kanë ardhur vetëm 22. Kemi qenë edhe ne disa deputetë të pozitës. Kjo është diferenca mes asaj seance edhe seancës së sotme.

Zoti kryesues, ne kemi ardhur sot që flasim për një platformë, në kohën kur deputetët e këtij Parlamenti të Kosovës flasin për procedura e për rregulla ndërkohë që ne si deputetë nuk kemi arritur që ta nxjerrim një Rregullore të re Kuvendit të Republikës së Kosovës, por punojmë me të njëjtën Rregullore prej vitit 2010 deri në vitin 2019.

E tha zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj se gjoja nuk ka dallime mes nesh dhe opozitës për mënyrën e dialogut dhe të bisedimeve me Serbi. Ka shumë dallime jo vetëm mes nesh dhe opozitës, por ka dallime të mëdha edhe brendapërbrenda neve, pozitës.

Në mënyrën qysh ne e mendojmë dialogun, në mënyrën qysh ne do të shkojmë përpara.

Sa i përket platformës së dialogut, unë dëshiroj të them vetëm diçka, ne mund të nxjerrim rezoluta, mund ta aprovojmë platformën, po ka edhe një mundësi tjetër që fuqitë e mëdha, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian t'i mbledhin të dyja delegacionet atë të Serbisë dhe të Kosovës dhe t'i çojë diku në bjeshkë në Norvegji atje ose në Suedi, t'i fusë në një vilë të izoluar dy-tre muaj deri sa të arrihet marrëveshja dhe pastaj do të binin në tokë komplet platformat.

Tek e fundit çdo dialog dhe çdo bisedë me çdokënd e përcakton vetëm forca, fuqia. Fuqinë e ka vetëm Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ta ulin Serbinë dhe ta bindin Serbinë që ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Unë mendoj që sot edhe shumë herë të tjera, deputetët e Parlamentit të Kosovës kanë diskutuar sikurse pikërisht sot që është ditë enjte. Ndërkaq, 105 vite më parë Bashkësia Ndërkombëtare e ka sjellë Princ Vidin në Shqipëri. Atë e kanë sjellë për arsye se shqiptarët në atë kohë nuk merreshin vesh mese vete.

I vetmi debat në Parlamentin e asaj kohe kur është sjellë Princ Vidi, në Parlamentin shqiptar ka qenë debati se a është bërë apo nuk është bërë synet Princ Vidi.

Sot, kemi folur në të njëjtën formë, domethënë nuk kemi folur për rëndësinë e dialogut. S'kemi folur për rëndësinë e bashkimit të spektrit politik për ndërtimin e një autostrade e cila na qon drejt finalizimit të njohjes së dyanshme të Kosovës dhe të Serbisë, por kemi folur, rrafsh tri orë jemi marrë me procedura. Deputetët janë marrë tri orë me procedura.

Po shihet qartë që Lidhja Demokratike e Kosovës, deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe deputetët e Vetëvendosjes duan të vijnë vetëm sa për ta bërë llugë.

Unë e kuptoj që duan ta bëjnë llugë dhe ta rrëzojnë Qeverinë, është krejt legjitime. Unë e kuptoj kur ata duan ta bëjnë llugë sa i përket ankesave dhe kritikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës në politikat e brendshme, qoftë për punësime, qoftë për keqpërdorimin e parasë publike, ku doli edhe sot, e keni në Kohën Ditore që një zëvendësministër nuk po e përmendi që është Agim Çeku, i ka keqpërdorur 12 mijë euro nga kartela e veta.

Por, pse duan këta ta bëjnë llugë në politikën e tyre të jashtme, që duan këta ta bëjnë llugë në bisedimet finale me Serbinë, në një diçka që na përket të gjithëve, këtë në mënyrë absolute nuk jam duke e kuptuar.

Në qoftë se Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shumë për letë që të vijë dhe ta bëjë një qeveri teknike, atëherë le urdhërojë, le ta ndezin debatin, le të vijnë të bisedojnë me ne deputetëve që duam t'i japim për rrëzimin e Qeverisë, le ta paraqesin këtu një platformë për një qeveri të re, dhe hajde le të urdhërojnë le ti bëjnë 61 vota dhe rrëzohet Qeveria. Ama jo të sabotohet. Jo të bojkotohen bisedimet me Serbinë, ku e gjithë Bashkësia Ndërkombëtare është duke na bërë ftesë që ne të ulemi në tryezën e bisedimeve.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Janë hapur dy vija të frontit. Janë hapur dy fusha politike në Kosovë në këta 8 muajt e fundit.

Në njëren fushë po luan jashtëzakonisht mirë Presidenti i Kosovës, zoti Hashim Thaçi. Ai po e përmend dizajnimin, ridizajnimin e kufijve. Bashkimin e Preshevë, Medvegjës dhe Bujanocit dhe asnjëherë nuk ka thënë që është për ndryshimin e kufijve. Me përjashtim që ka thënë që unë nuk besoj që ka shqiptar i cili është kundër bashkimit të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën.

Unë po i them këtu në foltore të Parlamentit që unë personalisht, në qoftë se është nevoja të bëhet çfarëdo lëvizje e kufirit i cili e prek pavarësinë e Kosovës, unë po e them publikisht, jam deputet i këtij Kuvendi, që unë jam kundër bashkimit të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Në qoftë se ju e pyesni edhe gomarin në rrugë: A je për bashkimin e trojeve shqiptare? Do të thotë; po. A jeni për bashkimin e trojeve shqiptare të Maqedonisë, pastaj bashkimin e Preshevës,

Medvegjës, Bujanocit me Kosovën, por edhe trojet shqiptare në Mal të Zi si Plavë, Guci, Ulqin, Tivar me Shqipërinë natyrale që ka qenë? Të gjithë do të thonë, po jemi të gjithë për bashkim.

Prandaj, të mos luajmë me dy karta. Me dy fronte.

O do ta mbrojmë atë pavarësi që e ka njohur Bashkësia Ndërkombëtare në vitin kur është shpallur më 2008 me Pakon e Ahtisarit ose do të ulemi dhe do të përgatitemi për një front tjetër. Të gjithë e dimë që procesi i bisedimeve do të jetë jashtëzakonisht i vështirë.

Dëshiroj ta përfundoj fjalimin tim duke cituar dy njerëz shumë të mëdhenj; Bill Klintonin i cili ka thënë që: “Vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë forcën dhe fuqinë për ta bindur Kinën dhe Rusinë që të pranojnë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Kosovën”.

Ndërsa, Faik Konica thotë: “Gjithmonë në momente të rënda historike shqiptarët janë marrë me cikërrime, nuk janë marrë me materie, por janë marrë me vogëlsira”.

Prandaj, ju ftoj të gjithëve si kolegë deputetë, t’i çojmë proceset përpara. Të ulemi në tryezën e bisedimeve dhe të votojmë për këtë platformë të mirë e të keqe, me defekte e pa defekte, sepse hapë rrugën e vazhimit të dialogut me Serbinë që po e kërkon Bashkësia Ndërkombëtare.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, unë si deputet e mbështesë platformën dhe i bëj thirrje edhe njëherë opozitës që të vijë dhe të na bashkohen në dialog me Serbinë në Bruksel. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,
Kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mora fjalën me qëllim të dhënies së kontributit të platformës për dialogun për shkak që është një dokument i cili është referencë e punës së delegacionit të Kosovës në bisedimet me Serbinë.

Unë kam qenë mbështetë i grupit delegues i cili do të dialogun me Serbinë dhe nuk jemi të përfshirë në këtë grup. Megjithatë, jemi duke e dhënë kontributin me ekspertë të caktuar të cilët janë duke e monitoruar këtë proces.

Pra, e mbështesim dialogun si një proces shumë i rëndësishëm dhe i patjetërsueshëm për zgjidhjen e raporteve tona mes Kosovës dhe Serbisë.

Unë më tepër e mora fjalën për t'u sqaruar me disa prej parimeve të parapara për shkak që vet dialogu është nënkuptuar dhe platforma është kuptuar si diçka gjithëpërfshirëse. Ndoshta prej anëtarëve të delegacionit ose hartuesve të kësaj platforme do duhej të marr përgjigje se çfarë është menduar në parimin 4, tek objektivat politike të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut synojnë zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura me Republikën e Serbisë duke përfshirë; pika b thotë: Avancimin e të drejtave të komunitetit shqiptar që jetojnë në Republikën e Serbisë në reciprocitet të plotë me komunitetin në Republikën e Kosovës.

Pse po e ngriti këtë dilemë? Për shkak se besoj që edhe delegacioni e di që në kuadër të këtyre të drejtave që duhet mbrojtur nga shteti i Kosovës, janë edhe të drejtat e komunitetit tim egjiptian që duhet të përfshihen, komunitet i cili për shkak të raporteve dhe pozicionit iu mohohen shumë të drejta për shkak të origjinës së tyre dhe prejardhjes së tyre që e kanë në shumicën e rasteve nga Kosova.

Është parimi 11.2. Delegacioni është zotuar që do të ketë gjithëpërfshirje. Procesi negociues do të zhvillohet në atë mënyrë që të mundësojë përfaqësimin e interesave të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ndërsa në 11. 3 thotë: Do të krijojë mekanizëm kontakti për të mundësuar pjesëmarrjen efektive në proces. Cili është ky mekanizëm? Domethënë për çfarë mekanizmi po bëhet fjalë? Dhe ne nuk jemi të përfshirë direkt dhe me siguri e ka për grupet të cilat nuk janë të përfshira.

Pika 12 tek pika g thotë: Kthimin e qytetarëve në pronat e tyre sikurse obligimet që Republika e Kosovës i ka marrë si pjesë e Planit të Ahtisarit për personat e zhvendosur. Qëndrimi i Kosovës është që të gjithë qytetarët duhet ta gëzojnë të drejtën e kthimit në pronat e tyre papengesë.

Kjo përfshinë kthimin e shqiptarëve në pronat e tyre në Veriun e Kosovës dhe në Serbi.

Mendoj se është e caktuar për komunitetin e caktuar. Besoj që edhe delegacioni e di që në kuadër të mohimit të këtyre të drejtave janë edhe komunitet tjera.

Unë besoj që anëtarët e delegacionit që janë nga komunitete joshumicë do duhej ta dinin këtë dhe thjesht në platformë do duhej të përfshiheshin edhe mbrojtja e pronës së komuniteteve të tjera; boshnjak, turk, rom, egjiptian e tjerë e tjerë. Ndërsa është e theksuar që flet vetëm për kthimin e shqiptarëve në pronat e tyre.

Ndërsa pika 14 ku flet për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, tek paragrafi i fundit thotë: Shqiptarët jashtë vendit duke përfshirë edhe ata që jetojnë në Republikën e Serbisë nuk duhet të kenë më pak të drejta për të shfaqur dhe treguar identitetin e tyre dhe për të jetuar me dinjitet sesa serbët që jetojnë Kosovë.

Procesi i dialogut duhet të sigurojë barazinë e dispozitave në të dyja anët në nivel të lartë të së drejtës ligjore.

Thjesht, me anë kësaj platforme e kam përshtypjen që po përjashtohen të tjerët për shkak që jemi në probleme të përbashkëta. Dhe mendoj që nëse përjashtohemi në këtë formë, dhe unë kam shumë besim delegacioni, por nëse përjashtohemi me platformë, atëherë mendoj që mund të humbet besimi mbi këtë bazë.

Të çështjet tjera pajtohem me zotin Daut Hardainaj, ngase do duhej që pikat kryesor të jenë; të zhdukurit, refugjatët, të vrarët të vendosen në pikat e para dhe në këtë çështje normalisht që edhe ne kërkojmë të drejta sepse në të njëjtat çështje jemi të përfshirë edhe ne.

Unë thjesht kërkoj sqarim dhe nëse është bërë ndonjë lëshim, do duhej dhe jam i gatshëm që ofrohem afër delegacionit në mënyrë që të jap kontributin tim për çështjet në fjalë dhe vërtetë të ketë gjithëpërfshirje. Faleminderit shumë! Edhe njëherë, e mbështesë platformën dhe do ta votoj, por mundësisht me ndryshimet që unë i mendova.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Zoti kryeministër në nëntor të vitit të kaluar kur është vendosur taksa për produktet ndaj Serbisë për 100% nuk mendoj që ka shqiptar që nuk ndjerë krenar për vendosjen e kësaj takse dhe nuk mendoj që ka shqiptar që nuk është ndjerë i lumtur, dhe nuk mendoj që ka shqiptar që nuk e di që Kosova ka fituar edhe ekonomikisht, po edhe politikisht deri sot me vendosjen e kësaj takse.

Kjo ka ndodhur si shkak vendosmërisë suaj kryeministër dhe vendosmërisë së liderëve tanë në Republikën e Kosovës.

Prandaj, po kërkoj që edhe me këtë platformë edhe në dialogun Kosovë-Serbi, zoti kryeministër edhe ju edhe delegacioni shtetëror ta kenë po të njëjtën vendosmëri që e keni për taksën.

Ta keni po të njëjtin seriozitet që e keni për taksën për çështjen e personave të pagjetur, për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Ne kemi diskutuar disa herë. Unë kam diskutuar edhe këtu në Parlament edhe jashtë Parlamentit, po edhe bashkë, që fati i personave të pagjetur duhet të ketë një epilog dhe ai epilog duhet të jetë pikërisht në dialogun Kosovë-Serbi në marrëveshjen finale.

Unë e lexova platformën në pika të shkurtra, sidomos tek pjesa e personave të pagjetur dhe po ua rikujtoj që maj të vitit të kaluar, ky Kuvend me 72 vota pro, që përkthehen në mbi 720 mijë qytetarë që kanë votuar ato, ka kërkuar nëpërmjet një rezolute të bëhet zbardhja e fatit e personave të zhdukur me forcë, bazuar në të drejtën ndërkombëtare, dhe të bëhet zbardhja e fatit e personave të zhdukur me forcë dhe të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi.

Në këtë platformë lerë më që nuk është parakusht zbardhja e fatit të personave të pagjetur, mirëpo nuk është as kusht, lerë më që nuk është kusht, por nuk mendoj që ka as seriozitet në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur në këtë platformë.

Në pikën d të parimit 4 të kësaj platforme thuhet: Zbardhja e fatit e personave të pagjetur, Republika e Kosovës do të kërkojë që çështja e personave të pagjetur të adresohet si temë.

Republika e Kosovës prej vitit 2000 ka kërkuar që zbardhja e fatit të personave të pagjetur të zgjidhet me Republikën e Serbisë, mirëpo kjo nuk ka ndodhur deri sot.

Prandaj, edhe njëherë kërkoj që vendosmërinë që e keni në tema tjera, ju dhe delegacioni shtetëror, ta keni të njëjtën vendosmëri edhe në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Kjo pikë, kjo çështje duhet të ketë epilog dhe ky epilog duhet të jetë në marrëveshjen finale Kosovë-Serbi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, është koha për pauzë. Kemi pauzë deri në orën 14:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ata të cilët janë në ambientet e Kuvendit i kisha lutur t'i zënë vendet në sallën kryesore parlamentare se jemi në vazhdimin e seancës.

* * *

Ju kisha lutur kolegë deputetë zini vendet për faktin se administrata po ka vështirësi në konstatimin e gjendjes në sallë. Ju lutem, edhe deputetët të cilët janë brenda Kuvendit, që janë deputetë, dëshirojnë të marrin pjesë në vazhdimin e seancës i kisha lutur të zënë vendet.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju lutem zini vendet edhe përgatitemi për votim të prezencës në sallë.

Regjia dhe deputetët. Edhe dy janë afër. Po e shohim se po më duket 61 janë aktualisht. Administrata po më thotë, për atë arsye veç ta shoh prezencën në mënyrë elektronike.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim. Votojmë tash!

Aktualisht janë 60 deputetë në sallë. Grupet parlamentare theksojnë se edhe dy deputetë janë duke ardhur. Një me dorë a? Sigurt? A ka mundësi i nderuar deputet? Regjia, vetëm ju votoni, ta shohim a funksionon a jo. Vetëm deputeti Avdyl Salihu.

Regjia. Në fakt regjia për deputetin, provoje. Voto të lutem! Atëherë, ndaleni, e ndalim procesin e votimit. Po shoh entuziazëm në votim. Do të votojmë edhe njëherë për prezencë.

Regjia, deputetët përgatiten për votim. Votojmë tash! Prezencën!

Prezencë fizike janë 61. Ta keni parasysh, por 60 po votojnë. A i presim edhe dy? A vonohen shumë? Ok! Presim, në mënyrë më korrekte.

Thërras deputetë të kthehen në sallë, ju kisha lutur. Janë me aq sa e shohim janë 62 deputetë prezentë. Ndërkohë, ziles ju lutem, regjia!

Para se të fillojmë seancën merrni shembull nga gazetarët të cilët nuk ndahen prej Kuvendit. I falënderoj për punën e tyre. Ju lumtë! Të gjithë të plotë.

Atëherë edhe një herë votojmë në mënyrë elektronike për prezencën.

Regjia, deputetët, votojmë tash!

62 deputetë janë në sallë. Unë e vazhdoj seancën. Jemi në vazhdimin e seancës. Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e tërheq fjalën, meqenëse besoj që shumica e atyre që kam dashur t'i them, janë thënë prej kolegëve të mi.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ilir Deda e ka kërkuar fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Qysh edhe e keni dëgjuar në fjalimin tim, unë i kam shprehur, jo më falni ka të bëjë me këtë votim. A jemi për platformë tash?

KRYETARI: Jemi për platformë, të lutem! I nderuar, ju keni folur.

ILIR DEDA: Jo, dëgjoni! Për ta përkrahur këtë platformë, janë dy çështje kyçe të cilat unë i shoh të rëndësishme pasi që nuk kam hapësirë më shumë intervenim të bëjë.

E para është definimi, kyçja e një fjalie e cila e definojnë parimin e panegociueshëm për Republikën e Kosovës dhe e dyta ka të bëjë me cilin kriter do të bëhet demarkacioni me Republikën e Kosovës. Kaq. Këto dyja. Në qoftë se merremi vesh për këto dyja, unë do ta votoj platformën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet!

A ka deputet tjetër që s'ka marrë fjalën, që dëshiron ta marrë fjalën. Nuk ka. Me kaq mbyllet debati për pikën e dytë të rendit të ditës të seancës së jashtëzakonshme mbi platformën e dialogut.

Duke pasur parasysh se e kemi pasur zhvillimin e kësaj seance të parakohshme siç ka qenë më herët, unë nuk do ta vë fare në votim, dhe do ta mbyllim këtu seancën. E mbyllim seancën e jashtëzakonshme, kalojmë në seancën e rregullt.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*